



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 56

Tiranë – E premte, 9 prill 2021

PËRMBAJTJA

Faqe

Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 14, datë 7.4.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në aktin normativ nr. 9, datë 22.3.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tekstit të marrëveshjes, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar “ <i>Keymen Ilaç Sanayi ve Ticaret</i> ” A.Ş, për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër COVID-19 (<i>Vero Cell</i>) <i>Coronovac</i> , të krijuar nga <i>Sinovac Life Science CO, LTD.</i> dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës”.....	5553
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 15, datë 7.4.2021	Për një ndryshim në aktin normativ nr. 1, datë 10.1.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tekstit të marrëveshjes për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet <i>Pfizer Export B.V.</i> dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Institutit të Shëndetit publik dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, autorizimin e procedurës për lejimin e hyrjes dhe administrimit të vaksinave Anticovid-19 në Republikën e Shqipërisë, si dhe përdorimin e tyre në popullatë”, miratuar me ligjin nr. 2/2021”, të ndryshuar.....	5553
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 192, datë 29.3.2021	Për delegimin e kompetencave.....	5554
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 178, datë 8.4.2021	Për zbatimin e urdhrit të ministrit nr. 91, datë 21.2.2019, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave teknike dhe të procedurave administrative, në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror”.....	5554
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 12, datë 9.3.2021	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 580, datë 16.3.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 390, datë 23.4.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2017-899 (72), datë 13.6.2017, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	5555

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 59, datë 25.2.2021	Mbi miratimin e licencës tip për veprimtarinë e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror.....	5963
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 60, datë 25.2.2021	Mbi miratimin e standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit.....	5970
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 61, datë 25.2.2021	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e një ndryshimi në “Rregulloren dhe metodologjinë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”.....	5576
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 62, datë 25.2.2021	Mbi heqjen e licencës nr. 53, seria NPM08P, dhënë shoqërisë “Alb Wind Energy” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 13, datë 28.1.2008, i ndryshuar.....	5577
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 3219, datë 6.4.2021	Për shpronësimin për interes publik për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga “Vendosja e servitutit të kalimit”, pjesë e projektit të Gazsjellësit Trans Adriatic Pipeline (Projekti TAP), në zonat Berat, Skrapar, Fier, Devoll dhe Korçë.....	5579
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 3220, datë 6.4.2021	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rikonstruksioni i rrugës ‘Ago Çeli’ dhe Rrugës së Re, si dhe rikonceptimi i palestrës së lagjes 15 Shtatori, Tepelenë”.....	5588
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 60/5, datë 7.4.2021	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare ‘17 Shkurti’, Qesarakë”.....	5590
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 62/4, datë 7.4.2021	Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Shtesë e impiantit të Përpunimit të ujit të pijshëm Bovillë me 1 800 l/sek, në fazën e dytë të zbatimit me 1 200 l/sek”.....	5592



AKT NORMATIV
Nr. 14, datë 7.4.2021

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË AKTIN NORMATIV NR. 9, DATË
22.3.2021, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
TEKSTIT TË MARRËVESHJES,
NDËRMJET MINISTRISË SË
SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE, MINISTRIT TË SHETIT PËR
RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË
SHËNDETIT PUBLIK DHE
DISTRIBUTORIT TË AUTORIZUAR
“KEYMEN ILAÇ SANAYI VE TICARET”
A.Ş, PËR FURNIZIMIN E REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË ME VAKSINËN E
INAKTIVIZUAR KUNDËR COVID-19
(VERO CELL) CORONAVAC, TË
KRIJUAR NGA SINOVA LIFE SCIENCE
CO, LTD. DHE TË PRODHUAR NË
REPUBLIKËN POPULLORE TË KINËS”**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në aktin normativ nr. 9, datë 22.3.2021, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Titulli i aktit normativ riformulohet, si më poshtë vijon:

“Për miratimin e marrëveshjes së furnizimit, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar “Keymen İlaç Sanayi ve Ticaret” A.Ş.”.

Neni 2

Në pikën 1, të nenit 1, pas fjalës “... Kinës ...” shtohen fjalët: “... dhe vaksinën CoronaVac 600 SU IM Suspension për injeksion të pakëtuar në një flakon 0,5 ml, e cila përmban substancën aktive antigjenin viral “Sars-CoV-2”, të inaktivizuar, të

zhvilluar nga Sinovac Life Sciences Co., Ltd., prodhuar në Republikën Popullore të Kinës dhe që pakëtohet në Republikën e Turqisë.”.

Neni 3

Miratimin e tekstit të marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së furnizimit, ndërmjet Ministrisë Shqiptare të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit Shqiptar të Shtetit për Rindërtim dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar “Keymen İlaç Sanayi ve Ticaret A.Ş”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

AKT NORMATIV
Nr. 15, datë 7.4.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË AKTIN
NORMATIV NR. 1, DATË 10.1.2021, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E TEKSTIT TË
MARRËVESHJES PËR PRODHIMIN
DHE FURNIZIMIN NGA DHE
NDËRMJET PFIZER EXPORT B.V. DHE
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË,
INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK
DHE MINISTRIT TË SHETIT PËR
RINDËRTIMIN, AUTORIZIMIN E
PROCEDURËS PËR LEJIMIN E HYRJES
DHE ADMINISTRIMIT TË VAKSINAVE
ANTICOVID-19 NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË, SI DHE PËRDORIMIN E
TYRE NË POPULLATË”, MIRATUAR
ME LIGJIN NR. 2/2021”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

Neni 1

Neni 2, i aktit normativ nr. 1, datë 10.1.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tekstit të marrëveshjes për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Institutit të Shëndetit Publik dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, autorizimin e procedurës për lejimin e hyrjes dhe administrimit të vaksinave anticovid-19 në Republikën e Shqipërisë, si dhe përdorimin e tyre në popullatë”, miratuar me ligjin nr. 2/2021, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 2

Aprovimi i përdorimit të vaksinës në popullatë

Vaksinat anticovid-19 aprovohen për përdorim në popullatë bazuar në aprovimet e *Food and Drugs Administration* të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (FDA), *European Medicine Agency* (EMA) të Bashkimit Evropian, të trupave të tjera certifikuese të vendeve që prodhojnë vaksina anticovid-19 si dhe vendeve të mbajtësit të autorizimit të tregtimit për vaksinat anticovid.”.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

URDHËR

Nr. 192, datë 29.3.2021

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; dhe të vendimit nr. 893, datë 4.11.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, zëvendëskryeinspektorit, z. Guri Seferi, deri në përfundim të procesit zgjedhor.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendëskryeinspektori i Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, z. Guri Seferi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

URDHËR

Nr. 178, datë 8.4.2021

**PËR ZBATIMIN E URDHËRIT
TË MINISTRIT NR. 91, DATË 21.2.2019,
“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
PËR PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE
TEKNIKE DHE PROCEDURAVE
ADMINISTRATIVE, NË LIDHJE ME
LICENCAT DHE CERTIFIKATAT E
KONTROLLORËVE TË TRAFIKUT
AJROR”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 7, pika 2, shkronja “ç” dhe nenit 27 të ligjit nr. 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, dhe në zbatim të vendimit nr. 1, datë 7.4.2021, të Komitetit të Mbrojtjes Civile,



URDHËROJ:

1. Përjashtimisht për situatën emergjente të krijuar në shërbimet e lundrimit ajror, në kushtet e mungesës së personelit rezervë të licencuar për ofrimin e këtij shërbimi, deri në një urdhër të dytë, pika 4, e nenit 2, të urdhrit të ministrit nr. 91, datë 21.2.2019, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave teknike dhe të procedurave administrative, në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror”, ndryshohet si më poshtë:

4. Për kontrollorët e trafikut ajror, që synojnë të ofrojnë shërbime të trafikut ajror në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë, pranë ofruesit të shërbimit të lundrimit ajror të Republikës së Shqipërisë, por që vendi kryesor i operimit dhe zyra e tyre e regjistrimit (nëse kanë), ndodhet jashtë territorit ku aplikohet kjo rregullore (ose ekuivalentja e saj në BE), do të njihet licenca e tyre, kur ata mbajnë një licencë të kontrollorit të trafikut ajror të lëshuar nga një vend anëtar i Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO), në përputhje me aneksin 1 të Konventës së Çikagos. Me njohjen e licencës, këta kontrollorë konsiderohen të licencuar, në përputhje me paragrafin 1 të kësaj rregulloreje.

Detyrat dhe funksionet e caktuara për kontrollorët e trafikut ajror të referuar në nënparagrafin e parë nuk do të tejkalojnë privilegjet e licencës së lëshuar nga vendi i tretë, jashtë ZPEA-së, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil të realizojë njohjen e licencave, sipas aneksit 1 të Konventës së Çikagos.

3. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

VENDIM

Nr. 12, datë 9.3.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare e Gjykatës Kushtetuese
Elsa Toska	anëtare e “ “
Marsida Xhaferllari	anëtare e “ “
Fiona Papajorgji	anëtare e “ “
Përparim Kalo	anëtar i “ “
Sonila Bejtja	anëtare e “ “

me sekretare Belma Lleshi, në datën 9.3.2021, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 47 (A) 2017 i Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Astrit Meli

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Nikolin Kodhima, Bukuriye Agaj, Gramoz Haxhiraj, Meleqe Binaj, Bajram Meminaj, shoqëria “Cika” sh.p.k., shoqëria “Sevast” sh.p.k., Agjencia e Trajtimin të Pronave, Këshilli i Rregullimit të Territorit bashkia Vlorë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 580, datë 16.3.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 390, datë 23.4.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2017-899 (72), datë 13.6.2017, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 18, pika 1, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); nenet 27, 31, 71, 71/a, 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuës, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, shoqërisë “Cika” sh.p.k., e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,



VËREN:

I Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin nr. 106, datë 19.6.1996, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Vlorë është vendosur njohja e pronësisë për një sipërfaqe truall prej 21.392 m², të ndodhur në lagjen “24 Maji” Vlorë, ish-pronarëve Kodhima, shtetasve XH.K., E.K., S.K. dhe XH.K., duke iu kthyer në natyrë 5.600 m² (prona objekt konflikti) dhe kompensimi për sipërfaqen prej 1.500 m². Si bazë për njohjen e kësaj prone rezulton të ketë shërbyer vendimi nr. 1449, datë 6.6.1995, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili është bazuar në vërtetimin e pronësisë nr. 2980/1, datë 20.10.1936.

2. Me vendimin nr. 352, datë 14.2.1997, KKKP-ja Vlorë ka njohur si ish-pronar shtetasin Jonuz Binaj, për një sipërfaqe toke bujqësore dhe ka kompensuar fizikisht trashëgimtarin e tij Meleqe Binaj (Haxhiraj) me një sipërfaqe prej 4.800 m² tokë truall në lagjen “Çole” të qytetit të Vlorës, pikërisht në vendin që po ky komision ka disponuar me vendimin nr. 106, datë 19.6.1996. Me deklaratën noteriale nr. 633 Rep., nr. 266 Kol., datë 1.3.2006, Meleqe Binaj ka hequr dorë nga regjistrimi i kësaj prone në favor të familjes Kodhima. Formalisht vendimi nr. 352, datë 14.2.1997, i KKKP-së Vlorë ka mbetur në fuqi.

3. Në datën 31.7.2006 është lidhur kontrata e shitjes nr. 2556 Rep., nr. 889 Kol. midis shitësve XH.K., E.K., S.K. dhe XH.K. dhe blerësve Gramoz Haxhiraj (djali i Meleqe Binaj) e Bukurie Agaj, me objekt shitjen e një sipërfaqeje toke prej 2.949 m². Në datën 31.7.2006 është lidhur kontrata e shitjes nr. 2559 Rep., nr. 891 Kol. midis po së njëjtës palë shitëse dhe blerëses Bukurie Agaj, me objekt shitjen e një sipërfaqeje toke prej 2.371 m². Të dyja këto pasuri bëjnë pjesë në pasurinë që shtetasve Kodhima u ishte kthyer me vendimin nr. 106, datë 19.6.1996, të KKKP-së Vlorë.

4. Për këtë truall është marrë edhe leja e sheshit të ndërtimit e datës 24.11.2008 dhe leja e ndërtimit e datës 23.2.2009, për ndërtimin e objekteve 8–10 kate.

5. Po ashtu, rezulton se shtetasi Xhelal Meli, duke pretenduar se është pronar i kësaj sipërfaqeje toke, i është drejtuar gjykatës me padi me objekt

detyrimin e të paditurve ta njohin pronar, anulimin e vendimeve të KKKP-së nr. 106, datë 19.6.1996 dhe nr. 352, datë 14.2.1997, si edhe pavlefshmërinë e të gjitha transaksioneve që janë bërë me këtë pronë. Ai ka paraqitur si provë përpara gjykatës një vërtetim arkivor, që përcakton madhësinë e sipërfaqes prej 7 vreten, në vendin e quajtur “Çole”, me kufij të përcaktuar të kohës. Sipas këtij vërtetimi arkivor, mbi këtë sipërfaqe toke ndodhej edhe një ndërtesë me konstruksion çimento e gurë e me çati me tjegulla dhe kjo pronë i është shpronësuar ish-pronarit Xhelal Meli në vitin 1948. Ky shtetas ka pretenduar se mbi themelet e kësaj ndërtese të vjetër pas viteve ‘90 ka ndërtuar një ndërtesë tjetër, që e përdor si punishte dhe që është në proces legalizimi. Sipas tij, nga verifikimet e kryera në arkivin pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Vlorë, nuk rezulton të ketë nr. 2980/1 në regjistrin hipotekor të vitit 1936. Po ashtu, ai ka pretenduar në gjykatë, se ky truall në mënyrë të kundërligjshme, me vendime të KKKP-së, i është kthyer personave joekzistentë dhe përfundimisht u ka kaluar të paditurve.

6. Gjatë gjykimit është paraqitur shtetasi Bajram Meminaj me kërkesë për ndërhyrje kryesore, duke pretenduar se as paditësi dhe as të paditurit nuk janë pronarë të kësaj prone, por pronar është trashëgimlënësi i tij, shtetasi M.M.

7. Me vendimin nr. 580, datë 16.3.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur: “1. *Pranimin e padisë së paditësit Xhelal Meli si të pabazuar në prova.* 2. *Pranimin e padisë së ndërhyrësit kryesor Bajram Meminaj. Detyrimin e Xhelal Melit të njohë trashëgimtarët e Muhamet Meminaj pronarë të një sipërfaqe truall prej katër vretenë ose 4.800 m² të ndodhur në lagjen “Çole” (sot lagja “24 Maji”), vendi Kume, me kufij të vjetër...* 3. *Detyrimin e të paditurve Bukurie Agaj, Gramoz Haxhiraj e Meleqe Binaj të njohin trashëgimtarët e Muhamet Meminaj pronarë të një sipërfaqe truall prej katër vretenë ose 4800 m² tokë truall të ndodhur në lagjen “Çole”, vendi Kume, me kufij të vjetër...* 4. *Shfuqizimin tërësisht të vendimit nr. 106, datë 19.6.1996, të ish-KKKP-së të Bashkisë Vlorë, si i dhënë në kundërshtim me ligjin.* 5. *Anulimin e vendimit nr. 352, datë 14.2.1997, të KKKP-së pranë Këshillit të Rrethit Vlorë.* 6. *Konstatimin e pavlefshmërisë së kontratave të shitjes së pasurive të paluajtshme: nr. 2556 rep. dhe nr. 889 kol., datë 31.7.2006; nr. 2559 rep. dhe nr. 891 kol., datë 31.7.2006, duke kthyer palët në gjendjen e mëparshme.* 7. *Detyrimin e ZVRPP-Vlorë të bëjë ç’regjistrimin e kësaj*



pasurie nr. 18/138, Zona Kadastrale 8604, në emër të të paditurve. 8. Anulimin e vendimit për miratimin e sheshtit të ndërtimit mbi truallin objekt konflikti miratuar në datën 24.11.2008 dhe të lejeve të ndërtimit të dy objekteve, 8–10 kate me nr. 1/41, datë 23.2.2009.”.

8. Me vendimin nr. 390, datë 23.4.2012, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. 580, datë 16.3.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.”. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë paditësi dhe të paditurit, si dhe ka paraqitur kundërrkurs ndërhyrësi kryesor.

9. Me vendimin nr. 00-2017-899 (72), datë 13.6.2017, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në seancë gjyqësore, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. 390, datë 23.4.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë.”.

10. Me kërkesën e datës 13.10.2017, kërkuksi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në proceset gjyqësore të zhvilluara në të tria shkallët e gjyqimit.

11. Me vendimin e datës 12.1.2018, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh.

II

Pretendimet e palëve

12. Kërkuksi Astrit Meli, në cilësinë e trashëgimtarit ligjor të shtetasit Xhelal Meli, në kërkesën e tij ka parashtuar se janë cenuar:

12.1 E drejta e aksesit në gjykatë. Gjykatat, pa e hetuar çështjen, kanë rrëzuar kërkesëpadinë me arsyetimin se paditësit i mungon legjitimitimi aktiv dhe se dokumenti arkivor i paraqitur prej tij nuk përbën provë për ta legjitimuar atë. Ky qëndrim i gjykatës është i gabuar, pasi legjitimitimi aktiv nuk ka lidhje me bazueshmërinë në prova të padisë, e cila lidhet me shqyrtimin e padisë në themelin e saj.

12.2 E drejta e mbrojtjes dhe parimi i kontradiktoritetit në gjykim. Në gjykimet në fakt nuk është ndërtuar drejt ndërgjyqësia dhe nuk janë thirrur në gjykim palë që kanë të drejta mbi pasurinë objekt konflikti. Po ashtu, gjykata ka marrë vendim për vazhdimin e gjyqimit në mungesë dhe nuk ka vijuar me njoftimin e palëve në mungesë kur ka shtyrë seancat gjyqësore. Për shkak të mosrespektimit të

rregullave të njoftimit gjykata e apelit duhej të vendoste kthimin e çështjes për rigjykim, në kuptim të nenit 467 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

12.3 Parimi i barazisë së armëve, pasi gjykata ka ngatërruar rolin e saj me të ekspertit, duke disponuar me vendim vetëm atë çka ka konstatuar eksperti, pa marrë dhe administruar në cilësinë e provave shkresore akte që vërtetojnë ose rrëzojnë këto konstatime. Kërkuksi është vënë në situatë të disfavorshme në krahasim me palën tjetër, pasi gjykatat jo vetëm që nuk kanë pranuar kërkesat e tij për paraqitjen e provave, por i kanë mohuar të drejtën që nëpërmjet gjykatës të sigurojë provat e nevojshme shkresore ose me dëshmitarë për të vërtetuar pretendimet e tij. Gjykatat nuk kanë marrë parasysh pretendimet e paraqitura nga palët dhe ato duhej të thërrisnin një grup ekspertësh për të saktësuar pronësinë e shtetasit Xhelal Meli.

12.4 E drejta për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm. Gjykata e apelit ka shkelur rregullat e përcaktuara në KPC, pasi ajo është tërhequr në dhomën e këshillimit për marrjen e vendimit në datën 16.3.2012 por e ka vonuar shpalljen e tij pa shkaqe të përligjura.

12.5 Parimi i gjyqimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Në zbatim të urdhërimit të nenit 181 të KPC-së, gjykimi në shkallë të parë nuk mund të vazhonte aty ku ishte lënë në momentin e ndërrimit të dy gjyqtarëve, por duhej të niste nga fillimi.

12.6 Parimi i paanshmërisë në gjykim. Gjyqtari H.S., i cili ka marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes në shkallë të parë, ka marrë pjesë më parë në dhënien e një vendimi për vërtetimin e faktit juridik të pronësisë, ku është pranuar se prona e shtetasit Xhelal Meli gjendet në vendin e pretenduar prej tij në padi.

12.7 Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor. Gjykatat i kanë mbështetur konkluzionet e tyre vetëm në përfundimet e ekspertit, sipas të cilit është e vështirë të pasqyrohet vendndodhja e pasurisë së shtetasit Xhelal Meli, ndërkohë që ajo do të përcaktohej lehtësisht nëse gjykatat do të thërrisnin ekspertë me njohuri të posaçme. Për më tepër aty ka ekzistuar edhe shtëpia e banimit dhe prona ka qenë e regjistruar edhe në regjistrin hipotekor të vitit 1942. Gjykatat janë shprehur se paditësit i mungon legjitimitimi aktiv, me arsyetimin se dokumenti arkivor i paraqitur nuk përbën provë për legjitimitimin, ndërkohë që dokumentin arkivor për pasurinë e Meminajve e konsideron si provë



për legjitimimin e ndërhyrësit kryesor. Gjykatat kanë anashkalluar dhe nuk i kanë dhënë përgjigje të arsyetuar as faktit se shtetasi Nikolin Kodhima është dënuar me vendim të formës së prerë për falsifikimin e vendimeve objekt i padisë që lidhen me kthimin e pronës. Pavarësisht shkeljeve të konstatuara në këtë proces gjyqësor, Gjykata e Lartë i legjitimoi ato duke lënë në fuqi vendimet e gjykatave të faktit.

13. Subjekti i interesuar, shoqëria “Cika” sh.p.k., në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës, ka prapësuar sa vijon:

13.1 Shoqëria “Cika” sh.p.k. për të zhvilluar aktivitetin në fushën e ndërtimit ka lidhur aktmarrëveshje me një nga pronarët e truallit, shtetasen Bukuriye Aga, e cila është bashkëpronare me shtetasin Gramoz Haxhiraj. Për këtë qëllim është marrë edhe leja përkatëse e vendimit dhe dokumentacioni i disponuar prej saj është i ligjshëm.

13.2 Marrja e masës së sigurimit nga gjykata, e pambështetur në ligj dhe në mungesë të kësaj pale ndërgjyqëse, ka bërë që të shkelen rëndë rregullat për formimin e ndërgjyqësisë.

13.3 Të tria shkallët e gjykimit nuk e kanë gjykuar në themel çështjen, sepse nuk janë bazuar në dokumentet arkivore që disponoheshin nga palët. Gjatë gjykimit vendndodhja e pronës, sipas dokumenteve arkivore, është zhvendosur, pra prona e shtetasit M.M. nuk është aty ku pretendohet. Harta topografike e paraqitur në gjykim nuk paraqet realitetin, sepse është ndryshuar në mënyrë të padrejtë. Për rrjedhojë, në rastin konkret është cenuar neni 42 i Kushtetutës.

14. Subjektet e tjera të interesuara nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim në lidhje me pretendimet e ngritura në kërkesën në shqyrtim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

15. Gjykata vë në dukje se prej datës 23 mars të vitit 2018 nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm ligjor të kërkuar nga neni 32, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000 për shqyrtimin e çështjeve në seancë plenare. Pas plotësimit të këtij kuorumi u bë e mundur marrja në shqyrtim e kësaj çështjeje.

16. Gjykata vëren, gjithashtu, se në datën 28.1.2021 gjyqtari Altin Binaj, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 36 të ligjit nr. 8577/2000, i ka

paraqitur Kryetares së Gjykatës Kushtetuese kërkesë me shkrim për heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje, për shkak të lidhjeve fisnore me subjektet e interesuara, Meleqe Binaj (Haxhiraj) dhe Gramoz Haxhiraj.

17. Me vendimin e datës 9.2.2021, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese ka vendosur pranimin e kërkesës së gjyqtarit Altin Binaj për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes nr. 47 (A) 2017 i Regjistrat Themeltar, me kërkuar Astrit Meli, në kuptim të pikës 2 të nenit 37, të ligjit nr. 8577/2000, pasi votat e gjyqtarëve u ndanë në mënyrë të barabartë.

A. Për legjitimimin e kërkuar

18. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

19. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

20. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuar legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në Gjykatën Kushtetuese dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

21. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve ligjore*, Gjykata ka theksuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion përfundimtar, që do të thotë se mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë marrë fund procedurat gjyqësore. Kontrolli i ushtruar nga Gjykata Kushtetuese, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit nga një proces i parregullt



ligjor, është një kontroll subsidiar, që do të thotë se individit duhet t'i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Shterimi nënkupton se kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 17, datë 16.5.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individit t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngrenë në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 8, datë 19.3.2018; nr. 31, datë 25.5.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, pasi, sipas tij, gjyqtari H.S., që ka marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes në shkallë të parë, ka qenë më parë pjesë e trupit gjykues që ka dhënë vendimin për vërtetimin e faktit juridik të pronësisë, ku është pranuar se kufitar i pronës është shtetasi Xhelal Meli, pra se prona e tij gjendet në vendin e pretenduar në padi.

23. Gjykata, bazuar në aktet bashkëlidhur kërkesës, vëren se ky pretendim i kërkuesit nuk është ngritur më parë në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë dhe as në parashtrimet e paraqitura në seancën gjyqësore para asaj gjykate. Në parashtrimet e tij drejtuar kësaj Gjykate kërkuesi ka pretenduar se e ka ngritur këtë pretendim në seancat gjyqësore në gjykatën e apelit dhe Gjykatën e Lartë, por nga aktet e dosjes gjyqësore, të administruar për qëllime të këtij gjykimi, konkretisht nga procesverbalet e seancave gjyqësore, nuk rezulton i provuar ky fakt. Gjykata vëren se kërkuesi jo vetëm që nuk ka paraqitur prova në mbështetje të pretendimit për cenimin e parimit të paanshmërisë nga pjesëmarrja në gjykim e gjyqtarit H.S., por nuk ka provuar se e ka shteruar këtë pretendim në shkallët e gjykimit të zakonshëm. Në këto kushte, për sa kohë që kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion, Gjykata nuk do të vijojë me vlerësimin e këtij pretendimi.

24. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-

mujor të parashikuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000.

25. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të kontradiktoritetit për shkak të mosformimit të drejtë të ndërgjyqësisë, si pasojë e mosthirrjes në gjykim të palëve që kanë të drejta mbi pasurinë objekt konflikti. Sipas tij, gjykata duhej të thërriste në gjykim shtetasen D.G., në emër të së cilës figuron e regjistruar prona objekt konflikti, si edhe trashëgimtarët e shtetasit M.SH. Gjykata vëren se, në kuptim të nenit 134, pika 2, të Kushtetutës, individit, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në ç'mënyrë ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese.

26. Për sa më sipër, për sa kohë që kërkuesi parashtron pretendime që nuk lidhen me cenimin e drejtpërdrejtë të së drejtës së tij kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, por kanë synim mbrojtjen e të drejtave të personave të tretë, ai nuk legjitimohet, pasi nuk ka provuar të drejtën e cenuar dhe interesin e tij të ligjshëm vetjak për mbrojtjen e saj.

27. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se gjykata e apelit ka shkelur rregullat e përcaktuara në KPC, pasi ajo është tërhequr në dhomën e këshillimit për marrjen e vendimit në datën 16.3.2012 dhe ka vendosur shtyrjen për shkak të kompleksitetit të çështjes. Sipas tij, edhe pse çështja ka qenë në gjykim në atë gjykatë për gati 1 vit, asaj i është dashur ende kohë për të konkluduar me vendim, duke vonuar shpalljen e tij pa shkaqe të përligjura. Në lidhje me këtë pretendim Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka arritur ta ngrejë në nivel kushtetues, duke mos arritur të provojë pasojat e ardhura dhe cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

28. Po në kuptim të legjitimit *ratione materiae*, pretendimet e tjera të ngritura nga kërkuesi janë të tilla që *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në gjykim

29. Sipas kërkuesit gjykatat, pa zhvilluar hetim gjyqësor, kanë rrëzuar kërkesëpadinë me arsyetimin se i mungon legjitimimi aktiv dhe se dokumenti arkivor i paraqitur prej tij nuk përbën provë për ta legjitimuar. Ky qëndrim i gjykatës është i gabuar,



pasi legjitimimi aktiv nuk ka lidhje me bazueshmërinë në prova të padisë, por kjo e fundit lidhet me shqyrtimin e padisë në themelin e saj.

30. Në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 56, datë 25.7.2017; nr. 21, datë 20.3.2017; nr. 52, datë 14.11.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjykata vëren se në vendimin nr. 580, datë 16.3.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka arsyetuar: “Duke iu referuar akteve në dosje rezulton se paditësi ka paraqitur si provë për të provuar pronësinë e tij një dokument arkivor të dalë nga Arkivi i Shtetit... Në këtë dokument arkivor jepen specifikimet e pronës dhe konkretisht... Ky dokument nuk është i shoqëruar me skicë. Për të përcaktuar faktin se ku ndodhet prona e paditësit dhe nëse midis saj dhe pronës së të paditurve apo asaj të pretenduar nga ndërhyrësi kryesor ka apo jo mbivendosje, nga gjykata u procedua me vendosjen e një eksperti. Në përfundim nga eksperti u arrit në përfundimin se për kufitarët e kësaj prone nuk ka asnjë dokument grafik... Për këto arsye, pra për faktin se dokumenti nuk ka hartë (skicë) apo nuk ka të përcaktueshëm kufijtë e pronës, ekspertja nuk mund të përcaktojë se ku ndodhet kjo pronë, pra nuk mund të përcaktohet nëse ndodhet pikërisht aty ku

të paditurit kanë pronën e tyre apo ndonjë vend tjetër. Nga paditësi nuk u sollën prova të tjera sikurse do të ishte dokumenti i pronësisë së kufitarit të tij apo ndonjë dokument tjetër për të bërë të mundur të përcaktohej se ku pikërisht është vendosur prona e tij. Pra, paditësi nuk arriti të provojë legjitimitetin aktiv në padinë e tij, pra nuk arriti të provojë cenimin e ndonjë interesi të tij të ligjshëm që të involvonte gjykatën në zgjidhjen e ndonjë konflikti me të paditurit. Për mungesë të legjitimitetit aktiv, gjykata pa i hyrë themelit të padisë së paditësit do ta rrëzojë atë si të pabazuar në prova.” Kurse në lidhje me legjitimimin aktiv të ndërhyrësit kryesor, gjykata ka vlerësuar se edhe pse prej tij u soll si provë një dokument arkivor i dalë nga Arkivi i Shtetit, i pashoqëruar me skicë, u paraqitën si provë edhe dokumentet e kufitarëve, në bazë të të cilave eksperti arriti në përfundimin se prona e tij ndodhet në vendin ku të paditurve u është kthyer prona me vendim komisioni.

32. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimes, në formë e në përmbajtje, siç sanksionohet në legjislacionin procedural, nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e së drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Në përputhje me këtë, neni 31 i KPC-së e ka përkufizuar padinë si të drejtën për t'u dëgjuar të personit që ngre pretendimin, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo në fakte e në ligje, kurse neni 32, shkronja “a”, parashikon se padia mund të ngrihet për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur (*shih vendimet nr. 38, datë 30.6.2014; nr. 5, datë 20.3.2006, të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas nenit 12 të KPC-së, pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin të provojë faktet mbi të cilat bazon pretendimin e saj. Në këtë kuptim, është pala që vë në lëvizje gjykatën që ka detyrimin të provojë pretendimet e saj dhe të paraqesë provat për këtë qëllim.

33. Në çështjen në shqyrtim rezulton se kërkuesi (paditësi në procesin gjyqësor), në mbështetje të pretendimit të ngritur në padi, për të vërtetuar pronësinë, ka paraqitur një dokument arkivor, i cili sipas gjykatës së zakonshme nuk ka qenë i mjaftueshëm për ekspertin e caktuar prej saj për të konkluduar në lidhje me vendin se ku ndodhet prona e përcaktuar në dokumentin arkivor. Mbi këtë vlerësim gjykata, duke iu referuar normave ligjore që lidhen me të provuarit e interesit të ligjshëm për të ngritur padinë, ka arritur



në përfundimin se kërkuksi nuk ka legjitimitimin aktiv në ngritjen e padisë në shqyrtim.

34. Për sa më sipër, Gjykata konstaton se kërkuksi, lirisht, ka ushtruar të drejtën e ngritjes së padisë dhe përmes një procesi gjyqësor, që ka analizuar themelin e çështjes, me vendim përfundimtar ka marrë përgjigje për të gjitha pretendimet e tij, përfshirë edhe atë të legjitimitimit aktiv.

35. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuksit është i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të kontradiktoritetit në gjykim

36. Sipas kërkuksit, gjykata ka marrë vendim për vazhdimin e gjyimit në mungesë të palëve dhe nuk ka vijuar me njoftimin e tyre kur ka shtyrë seancat gjyqësore. Mosrespektimi i rregullave për njoftimin përbën shkak për shfuqizimin e vendimit nga gjykata e apelit, e cila duhej të vendoste kthimin e çështjes për rigjykim, në kuptim të nenit 467 të KPC-së.

37. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshme të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjake në raport me palën kundërshtare (*shih vendimin nr. 37, datë 30.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Me qëllim garantimin e të drejtave të palëve në proces, gjykatave të zakonshme u dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në gjykim, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me

çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimin nr. 39, datë 5.5.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Gjykata ka vlerësuar, gjithashtu, se kontrolli i kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor vlerësohet në një kontekst të caktuar faktesh që lidhen me të drejtën për proces të rregullt ligjor. Rastet që i paraqiten Gjykatës mbi bazën e ankimit të individëve, duhet të shqyrtohen domosdoshmërisht në bazë të provueshmërisë së fakteve të dhëna. Marrja e vendimit për çështje kushtetuese kushtëzohet nga përcaktimi i fakteve kushtetuese, mbi bazën e të cilave vlerësohet respektimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Përdorimi i Gjykatës Kushtetuese ka autoritetin për të vendosur përfundimisht për çështje të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor, ajo nuk mund ta ushtrojë këtë kompetencë pa analizuar faktet e natyrës kushtetuese (*shih vendimin nr. 39, datë 5.5.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të kontradiktoritetit në gjykim për shkak të mosrespektimit të rregullave të njoftimit, kërkuksi nuk ka argumentuar se cilit proces i referohet konkretisht. Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, vëren se si në procesin gjyqësor të zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë, ashtu edhe atë në apel, paditësi ka marrë dijeni rregullisht për të gjitha seancat gjyqësore dhe rezulton se ai ka qenë i pranishëm në to ose personalisht, ose i përfaqësuar nga përfaqësuesit e zgjedhur prej tij. Edhe ato seanca gjyqësore ku paditësi ose përfaqësuesi i tij nuk kanë qenë të pranishëm, rezulton të jenë shtyrë për shkaqe të caktuara dhe nuk rezulton të jetë zhvilluar hetim gjyqësor ose të jenë kryer veprime të tjera procedurale në lidhje me çështjen.

41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim i kërkuksit është i pabazuar.

Ç. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve

42. Kërkuksi ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë së armëve, pasi gjykata ka ngatërruar rolin e saj me të ekspertit, duke disponuar me vendim vetëm atë çka ka konstatuar eksperti. Kërkuksi është vënë në situatë të disfavorshme në krahasim me palën tjetër, pasi gjykatat jo vetëm që nuk kanë pranuar kërkesat e tij për paraqitjen e provave, por i kanë mohuar të drejtën që, nëpërmjet gjykatës, të sigurojë provat e nevojshme shkresore ose me dëshmitarë për të vërtetuar pretendimet e tij.



Gjykatat nuk kanë marrë parasysh pretendimet e paraqitura nga palët dhe ato duhej të thërrisnin një grup ekspertësh për të saktësuar pronësinë e shtetasit Xhelal Meli.

43. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar, për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 13, datë 20.2.2017; nr. 34, datë 29.5.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Gjykata vëren se sipas nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, kur nuk formohet shumica prej 5 gjyqtarësh, kërkesa konsiderohet e rrëzuar. Bazuar në këtë dispozitë, në lidhje me pretendimin e kërkuarit për mospranimin nga gjykata e zakonshme të kërkesës për thirrjen në gjykim të një grupi ekspertësh, në kuptim të parimit të barazisë së armëve në gjykim, në kushtet kur nuk u arrit shumica e votave¹ në lidhje me bazueshmërinë ose jo në themel të këtij pretendimi, ai konsiderohet i rrëzuar.

D. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj

45. Sipas kërkuarit, në zbatim të urdhërimit të nenit 181 të KPC-së, gjykimi në shkallë të parë nuk mund të vazhdonte aty ku ishte lënë në momentin e ndërrimit të dy gjyqtarëve, por duhej të niste nga fillimi.

46. Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*”. Ky element karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të

zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimin nr. 2, datë 29.1.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Këtë parim Gjykata e ka parë të lidhur ngushtë edhe me përbërjen e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete (*shih vendimin nr. 69, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

47. Sipas përmbajtjes së nenit 181 të KPC-së, në fuqi në kohën e shqyrtimit të kësaj çështjeje: “*Gjykata duhet të organizojë punën që gjykimi i çështjes të përfundojë nga i njëjti trup gjykues. Kur për shkaqe të parashikuara nga paragrafi i tretë i nenit 62 të këtij Kodi, ose për shkaqe të tjera të përligjura, ndryshon përbërja e trupit gjykues, anëtari i ri duhet të njihet me përmbajtjen e procesit gjyqësor, përveç kur kërkohet prej tij që çështja të shqyrtohet nga fillimi. Kur ndryshon më shumë se një nga anëtarët e trupit gjykues, çështja fillon nga fillimi*”. Gjykata vëren se gjykimi i kësaj çështjeje në shkallë të parë ka filluar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët A.M., G.H. dhe TH.N. Me shortin e datës 7.4.2009, trupi gjykues është plotësuar me gjyqtarin E.M., i cili ka zëvendësuar gjyqtarin G.H., që është emëruar në një gjykatë tjetër. Në seancën gjyqësore të datës 7.4.2009, ku ka qenë i pranishëm kërkuari dhe përfaqësuesi i tij, gjykata u ka bërë me dije palëve zëvendësimin e anëtarit të trupit gjykues, i cili është shprehur që “*gjykimi të vazhdojë aty ku ka mbetur*”. Kurse me shortin e datës 24.11.2009 trupi gjykues është plotësuar me gjyqtarin H.S., i cili ka zëvendësuar gjyqtarin TH.N. Në seancën gjyqësore të datës 25.11.2009, ku kërkuari dhe përfaqësuesi i tij kanë qenë të pranishëm, palët janë njohur me përbërjen e re të trupit gjykues dhe gjyqtari H.S. ka kërkuar “*të procedohet në atë fazë në të cilin ka ngelur gjykimi pasi u njoh me materialet e dosjes*”. Në të dyja këto seanca gjyqësore palët kanë qenë dakord me trupin gjykues dhe nuk kanë pasur kundërshtime ose vërejtje. Po ashtu, rezulton se zëvendësimi i anëtarëve të trupit gjykues, në të dyja këto raste, është bërë në bazë të shortit, duke u respektuar dispozitat përkatëse procedurale.

48. Rezulton, gjithashtu, se ky pretendim i kërkuarit është marrë në shqyrtim edhe nga Gjykata e Lartë, e cila, në zbatim të kompetencës së saj për interpretimin e ligjit dhe vlerësimin të

¹ Votuan për pranimin e këtij pretendimi gjyqtarët: Marsida Xhaferllari, Përparim Kalo dhe Sonila Bejtja.

Votuan për rrëzimin e këtij pretendimi gjyqtarët: Vitore Tusha, Elsa Toska dhe Fiona Papajorgji.



zbatimit të tij nga gjykatat më të ulëta, ka vlerësuar, se: “*zëvendësimet e anëtarëve janë bërë në kohë të ndryshme dhe jo në të njëjtën seancë gjyqësore dhe nga ana e tyre është deklaruar se janë njohur me materialet e dosjes dhe janë dakord që të vazhdojnë gjykimin aty ku ka ngelur. Në asnjë seancë nuk rezulton që të jenë ndryshuar më shumë se një nga anëtarët e trupit gjyqësor.*”.

49. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuarit është i pabazuar.

DH. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

50. Sipas kërkuarit, gjykatat i kanë mbështetur konkluzionet e tyre vetëm në përfundimet e ekspertit, sipas të cilit është e vështirë të pasqyrohet vendndodhja e pasurisë së shtetasit Xhelal Meli, ndërkohë që ajo do të përcaktohej lehtësisht nëse do të thërrisnin ekspertë me njohuri të posaçme. Për më tepër, aty ka ekzistuar edhe shtëpia e banimit dhe prona ka qenë e regjistruar edhe në regjistrin hipotekor të vitit 1942. Gjykatat janë shprehur se paditësit i mungon legjitimimi aktiv, me arsyetimin se dokumenti arkivor i paraqitur nuk përbën provë për legjitimimin, ndërkohë që dokumentin arkivor për pasurinë e Meminajve e konsideron si provë për legjitimimin e ndërhyrësit kryesor. Gjykatat duhej të arsyetonin nëse pasuria e ndërhyrësit kryesor është brenda pasurisë së trajtuar me vendimin e AKKKP-së Vlorë për të cilën është vendosur sekuestro preventive. Ato nuk i kanë dhënë përgjigje të arsyetuar as faktit se shtetasi Nikolin Kodhima është dënuar me vendim të formës së prerë për falsifikimin e vendimeve objekt i padisë që lidhen me kthimin e pronës. Pavarësisht shkeljeve të konstatuara në këtë proces gjyqësor, Gjykata e Lartë i legjitimoi ato duke lënë në fuqi vendimet e gjykatave të faktit.

51. Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Domosdoshmëria e arsyetimit të vendimeve gjyqësore është një garanci për procesin ligjor. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

52. Gjykata vëren se edhe në lidhje me pretendimin për mungesën e arsyetimit nga gjykatat e zakonshme, lidhur me pretendimet e parashtuara në gjykim nga kërkuari për sa i takon vendndodhjes së pronës, nuk u arrit shumica e votave të gjyqtarëve², ndaj ai konsiderohet i rrëzuar në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000.

53. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuari Astrit Meli është e pabazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72, 73, pika 4, e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 9.3.2021.

Shpallur më 6.4.2021.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Përparim Kalo, Fiona Papajorgji

VENDIM

Nr. 59, datë 25.2.2021

MBI MIRATIMIN E LICENCËS TIP PËR VEPRIMTARINË E OPERIMIT NË HAPËSIRAT E DEPOZITIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 22 dhe nenit 23, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; si dhe nenet 15 dhe 26, të “Rregullores për organizimin,

² Votuan për pranimin e këtij pretendimi gjyqtarët: Marsida Xhaferllari dhe Fiona Papajorgji.

Votuan për rrëzimin e këtij pretendimi gjyqtarët: Vitore Tusha, Elsa Toska, Përparim Kalo dhe Sonila Bejtja.



funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.2.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 30/10 prot., datë 23.2.2021, të përgatitur nga drejtoritë teknike, mbi miratimin e licencës TIP për veprimtarinë e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror,

konstatoi:

- Me vendimin nr. 193, datë 20.11.2020, Bordi i ERE-s ka filluar procedurën për miratimin e licencës TIP për veprimtarinë e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror.

- Me shkresën nr. 62/39 prot., datë 27.11.2020, ERE ka vijuar me publikimin në media të njoftimit për fillimin e procedurës për miratimin e licencës TIP për veprimtarinë e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror, duke ftuar palët e interesit të shprehin komentet apo sugjerimet mbi këtë draft.

- Me shkresën nr. 1224 prot., datë 27.11.2020, janë kërkuar komente dhe opinione nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Konkurrencës, shoqëritë “Albgaz” sh.a., “Albpetrol” sh.a., “TAP AG Albania” sh.p.k.,

“Anio Oil&Gas” sh.p.k., “Phoenix Petroleum” sh.a., “C.G.C.” sh.p.k. dhe “Balkgaz” sh.p.k.

- Në përgjigje të kërkesës për komente dhe opinione është shprehur Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila parimisht është dakord që Bordi i ERE-s të ndjekë procedurën për miratimin e licencës TIP për veprimtarinë e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë licencën TIP për veprimtarinë e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror.

2. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

LICENCË PËR VEPRIMTARINË E OPERIMIT NË HAPËSIRAT E DEPOZITIMIT TË GAZIT NATYROR

Numri i licencës:

Seria:

Shoqëria:

NUIS:

Data e hyrjes në fuqi:

Kohëzgjatja:

Kushte të tjera:

Bazuar në autoritetin që i është dhënë në seksionin e dytë të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) i jep këtë licencë operimi në hapësirat e depozitimit të gazit natyror (licenca), për të kryer aktivitetin e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror, personit të lartpërmendur, i quajtur (i licencuari), subjekt i kushteve të kësaj licence, si dhe kushteve të përcaktuara në vendimin e Bordit të ERE-s nr. __, datë __. __. __. Kjo licencë hyn në fuqi në datën e shkruar më lart dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi për një periudhë prej ____ vjetësh, në rast se nuk përfundohet ose hiqet nga ERE, në përputhje me kushtet e licencës të përfshira këtu.

[KRYETAR]
[Vula e ERE-s]



**KUSHTET E LICENCËS
PËR VEPRIMTARINË E OPERIMIT
NË HAPËSIRAT E DEPOZITIMIT TË
GAZIT NATYROR**

Numri i licencës: _____

I jepet: _____
(emri i plotë i të licencuarit)

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

1. ERE është autoriteti i vetëm në Republikën e Shqipërisë, i njohur sipas ligjit dhe ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, që lëshon dhe deklaron hyrjen në fuqi të kësaj licence.

2. Nëse ndonjë kusht i kësaj licence pushon së qeni efektiv, ai kusht do të hiqet nga kushtet e licencës dhe kushtet e mbetura do të vazhdojnë të jenë në fuqi.

3. Kjo licencë nuk do t’i transferohet, tërësisht ose pjesërisht, asnjë personi tjetër pa miratimin paraprak me shkrim të ERE-s. Kur miraton një transferim, ERE mund ta modifikojë periudhën e licencës ose kushtet e tjera të licencës, pasi të ketë arsyetuar vendimarrjen.

4. ERE ndryshon licencën në përputhje me nenin 28, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, si dhe parashikimet e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, në rastet e mëposhtme:

- a) me iniciativën e vet;
- b) në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë;
- c) kur ndryshojnë kushtet, për të cilat është dhënë licenca;
- d) me kërkesën e të licencuarit.

5. I licencuari mund të kërkojë një modifikim të kësaj licence nëpërmjet një kërkesë të detajuar me shkrim, si dhe dokumentacionit mbështetës, në përputhje me “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”.

Përkufizimet e termave të përdorur në këtë licencë, janë sipas përcaktimeve të:

- Ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar;

- “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017;

- “Rregulloren mbi procedurat e heqjes së licencave në sektorët e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017;

- “Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016;

- Rregullat dhe rregulloret që i përkasin sektorit të gazit natyror (legjislacioni në fuqi).

Neni 2

Kryerja e aktivitetit të licencuar

1. I licencuari autorizohet nga kjo licencë për kryerjen e veprimtarisë së licencuar.

2. I licencuari nuk do të bashkëpunojë në asnjë mënyrë me të licencuar të tjerë lidhur me veprimtarinë e licencuar në dëm të tregtuesve, furnizuesve ose klientëve dhe përdoruesve ekzistues ose të mundshëm.

3. I licencuari nuk do të angazhohet në kryerjen e veprimeve ose në ndonjë aktivitet tjetër që përbën sjellje antikonkurruese, sipas legjislacionit në fuqi.

4. I licencuari nuk do të angazhohet në veprimtari të tjera, që pengojnë ose mund të pengojnë kryerjen si duhet të veprimtarisë së licencuar. I licencuari do të njoftojë ERE-n para se të ndërmarrë ndonjë veprimtari, përveç veprimtarisë së licencuar.

5. I licencuari nuk do të pengojë, parandalojë ose të përpiqet të parandalojë të licencuar të tjerë apo konkurrues potencialë që të angazhohen ligjërisht ose të hyjnë në biznesin e gazit natyror në Republikën e Shqipërisë.

6. Gjithë marrëveshjet për ofrimin e shërbimit të depozitimit të gazit natyror duhet të përputhen me legjislacionin në fuqi për aq sa kërkohet nga këto të fundit.

7. Të gjitha marrëveshjet që i licencuari do të lidhë me palë të treta, do të respektojnë parimet e parashikuara në kodet e gazit natyror dhe mund të jenë objekt monitorimi nga ERE për të siguruar funksionimin e tregut dhe që të licencuarit nuk ushtrojnë ndikim mbi tregun, duke ndjekur



praktika të padrejta dhe që bien ndesh me legjislacionin për konkurrencën.

Neni 3

Detyrimet e të licencuarit

1. I licencuari do të respektojë legjislacionin në fuqi gjatë ushtrimit të funksioneve, sipas kësaj licence.

2. I licencuari do të ndërmarrë masat e nevojshme për garantimin e aftësive teknike dhe financiare për kryerjen e aktivitetit të licencuar.

3. I licencuari do të regjistrohet si pjesëmarrës i tregut shqiptar të gazit natyror pranë Operatorit të Tregut të Gazit Natyror, sipas procedurave të regjistrimit dhe do të zbatojë legjislacionin në fuqi dhe vendimet e ERE-s.

4. I licencuari do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për përmirësimin e eficiencës operative dhe ekonomike të veprimtarisë së licencuar, me qëllim që të sigurojë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve të ofruara prej tij në përfitim të klientëve dhe të sektorit të gazit natyror.

5. I licencuari do të përbushë të gjitha rregullat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të miratuara nga ERE, përfshirë zbatimin e gjithë urdhrave operativë, udhëzimeve, si dhe paraqitjen e informacionit teknik dhe gjithë dokumentacionit tjetër, sipas kërkesave të Kodit të Rrjetit të Transmetimit të Gazit Natyror dhe rregullave të tregut të gazit natyror.

6. I licencuari do të zbatojë rregullat e përdorimit të sistemit të depozitimit të gazit që përcaktojnë zhvillimin, menaxhimin dhe përdorimin e këtij sistemi dhe në veçanti, parashikojnë:

- a) përshkrimin e sistemit të depozitimit të gazit;
- b) zhvillimin, ndërtimin e mirëmbajtjen e sistemit të depozitimit të gazit;
- c) menaxhimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të depozitimit të gazit;
- ç) marrëdhëniet kontraktuale dhe kushtet e përgjithshme për përdorimin e sistemit të depozitimit të gazit;
- d) rezervimin dhe përdorimin e kapaciteteve në sistemin e depozitimit të gazit;
- dh) tregtimin e kapaciteteve të sistemit të depozitimit të gazit;
- e) të drejtat dhe detyrimet e operatorit e përdoruesit të sistemit të depozitimit të gazit;

- ë) rregullat e matjes dhe rregullat e shpërndarjes;
- f) publikimin e të dhënave dhe shkëmbimin e informacionit;
- g) lidhjen me pjesët e tjera të sistemit të gazit;
- gj) kompensimin e dëmeve.

Neni 4

Llogaritë dhe raportimi

1. I licencuari do të mbajë regjistra llogarie dhe do të përgatisë balance financiare konform legjislacionit në fuqi dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit. I licencuari do t'i dorëzojë ERE-s bilanci financiar vjetor së bashku me raportet e auditit brenda datës 31 mars të çdo viti. I licencuari mban llogari të veçanta financiare për veprimtari të tjera të gazit, të cilat mund të jenë të konsoliduara, duke mbajtur të ndara edhe llogaritë që nuk lidhen me veprimtaritë e parashikuara në këtë ligj.

2. I licencuari mban llogari të veçanta për secilën nga veprimtaritë e licencuara që ushtron, si dhe për çdo veprimtari tjetër që nuk lidhet me sektorin e gazit natyror, me qëllim shmangien e ndërsubvencionimit dhe cenimit të konkurrencës. Këto llogari mund të paraqiten të konsoliduara, përveç rastit kur veprimtaritë e kryera lidhen me shpërndarjen apo me transmetimin e gazit natyror.

3. Të licencuarit i kërkohet të përgatisë dhe t'i paraqesë ERE-s më 31 janar të çdo viti, një raport vjetor lidhur me operimet e tij gjatë vitit të mëparshëm kalendarik, që përmban sa më poshtë:

- a) një përmbledhje dhe analizë të operimit në veprimtarinë e licencuar;
- b) sasinë e gazit të depozituar, si dhe koston e shërbimit të depozitimit;
- c) çdo ndërprerje të veprimtarisë, si dhe përshkrim të arsyeve të ndërprerjes;
- d) një përmbledhje dhe analizë të kontratave të lidhura për ofrimin e shërbimit të depozitimit të gazit natyror në fuqi dhe gjatë vitit që raportohet.

4. I licencuari do t'i paraqesë ERE-s, me kërkesën e saj dhe sipas formës dhe brenda kohës së vendosur nga ERE, çdo informacion që është i domosdoshëm për ERE-n për të kryer përgjegjësitë e saj rregullatore të autorizuar.

5. I licencuari do të vërë në dispozicion të ERE-s, ministrisë përgjegjëse, Autoritetit të Konkurrencës dhe autoriteteve të tjera përgjegjëse, të dhënat përkatëse, për një periudhë të paktën 5 vjet, në lidhje me të gjitha transaksionet, në



kontratat e lidhura për qëllime të kryerjes së shërbimit të depozitimit të gazit natyror dhe derivativëve të tij, me klientët OST-në, operatorët e sistemit të depozitimit dhe të sistemit të GNL-së.

6. Këto të dhëna vihen në dispozicion edhe të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, po për të njëjtën periudhë.

7. Të dhënat duhet të përfshijnë detaje për karakteristikat e transaksioneve përkatëse, si: kohëzgjatja, rregullat e ofertës dhe të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, sasinë, datat, kohën e ekzekutimit të kontratës, çmimet e transaksionit, mjetet e identifikimit të klientëve të përfshirë, si dhe detaje për të gjitha kontratat e papaguara.

8. ERE mund të vërë në dispozicion të pjesëmarrësve të tregut të dhëna të caktuara, të deklaruara nga i licencuari, me kusht që të mos publikohet informacioni që përbën sekret tregtar.

9. I licencuari do të njoftojë ERE-n, brenda 10 ditëve për çdo ndryshim, të:

- a) adresës zyrtare përfshirë dhe atë elektronike;
- b) statutit të të licencuarit;
- c) certifikatës së regjistrimit;
- d) NUIS-it;
- e) drejtuesve të lartë.

10. Të gjitha njoftimet zyrtare, aplikimet, petitionet, deklaratat ose korrespondenca tjetër me ERE-n, lidhur me detyrimet, sipas kësaj licence, duhet të jenë me shkrim, duke caktuar respektivisht nga një zyrtar të autorizuar ose përfaqësues tjetër të të licencuarit ose të ERE-s. Këto dërgohen me korrier ose postë të regjistruar, duke kërkuar një verifikim të fletës së marrjes. Adresat e palëve duhet të vendosen mbi zarf. Gjithë njoftimet ose korrespondenca tjetër do të konsiderohen se hyjnë në fuqi nga momenti i dorëzimit ose nëse nuk janë dorëzuar për shkak të gabimit të dërguesit, nga momenti i prezantimit. Do të konsiderohen të pranuar edhe gjithë njoftimet e dërguara përmes postës elektronike zyrtare të komunikuar më parë nga palët.

Neni 5

Përdorimi i informacionit

1. Sipas ligjit, Kodit të Transmetimit, Kodit të Shpërndarjes, “Rregullave të tregut të gazit natyror” dhe kërkesave të rregulloreve përkatëse, i licencuari do të sigurojë që, çdo informacion i marrë nga të

tjerët si rezultat i veprimtarisë së tij të licencuar, nuk do t’i jepet askujt, përveç rasteve kur:

- a) ka pëlqimin paraprak me shkrim të personit me çështjet e të cilit lidhet informacioni;
- b) informacioni është tashmë i njohur për publikun;
- c) kur të licencuarit i kërkohej ose i lejohet ta përhapë informacionin për të përmbushur kushtet e kësaj licence, çdo urdhër të ERE-s dhe legjislacionit në fuqi.

2. Me kërkesën e ERE-s, i licencuari do të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm për ta mbrojtur informacionin konfidencial që posedon dhe do t’i paraqesë ERE-s raporte që lidhen me respektimin e detyrimeve të parashikuara në nenin 7.

3. Informacioni që i sigurohet ERE-s nga i licencuari do të konsiderohet publik, përveç kur me kërkesë të veçantë të të licencuarit, ERE, me vendim, siguron se ky informacion është i natyrës pasurore dhe se interesi publik të cilit i shërbehet nga përhapja e tij, nuk do ta justifikojë ose kompensojë dëmin komercial potencial ndaj të licencuarit.

Neni 6

Pagesat e rregullimit

1. I licencuari do të paguajë pagesën e rregullimit në mënyrën e përcaktuar nga ERE gjatë afatit të kësaj licence, në përputhje me nenin 14, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

2. Nëse i licencuari nuk i paguan ERE-s pagesat e rregullimit, brenda afatit të kërkuar nga ERE, ndaj të licencuarit do të merret masë administrative, në përputhje me nenin 106, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, si dhe “Rregulloren mbi kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje”.

Neni 7

Kontrolli mbi performancën e veprimtarisë së licencuar

1. ERE do të monitorojë respektimin nga i licencuari të kushteve të licencës, do të rishikojë raportet e marra nga i licencuari dhe është e autorizuar që të inspektojë në çdo kohë regjistrat financiarë të të licencuarit dhe mund të kërkojë një



auditim teknik dhe/ose financiar të veprimtarive të të licencuarit.

2. Përfaqësuesit e autorizuar të ERE-s mund të hyjnë në ambientet, pajisjet dhe dokumentet e të licencuarit për të inspektuar veprimtarinë e licencuar, sipas rregullave të ERE-s. I licencuari do të japë çdo ndihmë të kërkuar nga ERE gjatë këtij inspektimi.

3. Në bazë të ankesës së konfirmuar të çdo pale të tretë ose me iniciativën e vet, ERE mund të nisë një hetim administrativ për respektimin nga i licencuari të kushteve të licencës ose të rregullave të ERE-s.

4. Nëse pas hetimit, ERE konkludon se i licencuari nuk i ka respektuar kushtet e licencës, ERE mundet të ndërmarrë masa të tjera brenda autoritetit të saj, me qëllim që të sigurojë përmbushjen e afateve dhe të kushteve të kësaj licence.

5. I licencuari do ta informojë dhe do ta sqarojë ERE-n për çdo shkelje të kushteve të licencës, jo më vonë se një javë pasi kjo shkelje i bëhet e njohur të licencuarit.

6. I licencuari do t'u bindet vendimeve të nxjerra nga ERE, përfshirë pagesat e gjobave të vëna nga ERE, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 8

Vendosja e masave administrative dhe heqja e licencës

1. Nëse i licencuari nuk përmbush kushtet e kësaj licence, ERE mund të aplikojë masa administrative, sipas nenit 106, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

2. ERE mund të heqë licencën në përputhje me nenin 27, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, dhe “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.

Neni 9

Heqja e licencës

1. ERE heq një licencë kur i licencuari:

a) nuk përmbush më kushtet thelbësore të licencës;

b) shkel dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;

c) rrezikon jetën, shëndetin dhe pasurinë e qytetarëve;

d) nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE;

e) bëhet financiarisht i paafte ose kërkon shpalljen e falimentimit;

f) ka bërë kërkesë për heqje licence;

g) ka pushuar së kryeri funksionet e caktuara sipas licencës.

2. Nëse i licencuari ndryshon statusin e tij ligjor ose aksionari kryesor/ortaku që kontrollon interesat e të licencuarit ndryshohet pa autorizim nga ERE, atëherë ai do të jetë subjekt i vendosjes së masave administrative në bazë të nenit 106, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar

3. Kjo licencë mund të transferohet vetëm me vendim të ERE-s dhe sipas afateve dhe kushteve të vendosura nga ERE. Çdo vendim i ERE-s për ndonjë transferim të kësaj licence do të jetë objekt i vendimmarrjes së ERE-s, nëse personi të cilit i transferohet licenca do të ketë aftësinë teknike dhe financiare për të plotësuar afatet dhe kushtet e kësaj licence.

4. Çdo transferim i kësaj licence, pa miratimin e ERE-s, do të anulohet dhe do të përbëjë një shkelje të kësaj licence.

5. Kur licenca përfundon si pasojë e shkeljeve nga i licencuari të kushteve të licencës, i licencuari do të përgjigjet për koston që i shkakton ERE-s dhe pjesëmarrësve të tregut si rezultat i këtij përfundimi, siç përcaktohet nga ERE, përfshirë kostot lidhur me transferimin e rregullt të licencës të një i licencuar i ri.

6. Kur ERE konstaton, se i licencuari ka shkelur një ose më shumë kushte të licencës, të licencuarit mund t'i jepet një mundësi e arsyeshme për ta korrigjuar shkeljen para përfundimit të licencës, përveç kur shkelja përfshin korrupsion ose pandershmeri të vërtetuara nga organet me autoritetin përkatës, sipas ligjeve në fuqi.

Neni 10

Situatat e emergjencës

1. I licencuari nuk do të konsiderohet se ka shkelur kushtet e kësaj licence, në rast se parandalohet në përmbushjen e tyre nga forca madhore ose rrethana të tjera emergjence.

2. Në kushtet e emergjencës, i licencuari:



a) do të sigurojë bashkëpunimin e nevojshëm me autoritetet dhe institucionet përgjegjëse për të vepruar në situatë emergjence, me qëllim që të rifillojë veprimtarinë brenda një periudhe kohore sa më të shkurtër;

b) do të plotësojë detyrimet e tij për reduktimin e rreziqeve dhe të humbjeve lidhur me jetën, shëndetin dhe pronën e palëve të treta;

c) Brenda 24 orëve nga ngjarja e emergjencës, i licencuari do të njoftojë ERE-n për situatën e emergjencës dhe veprimet që do të ndërmarren për të rifilluar veprimtarinë normale.

3. Nëse i licencuari e parashikon situatën e emergjencës, siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi, i licencuari do të njoftojë ERE-n brenda 24 orëve dhe ky njoftim do të përshkruajë se çfarë hapash do të marrë i licencuari për të mënjanuar ose për të përmirësuar ndikimet e situatës emergjente të parashikuar.

Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe e drejta për ankimim

1. Çdo çështje e diskutueshme ose pretendim mes të licencuarit dhe çdo pjesëmarrësi në treg lidhur me kushtet e licencës dhe me zbatimin e legjislacionit në fuqi do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.

2. Nëse zgjidhja nuk arrihet me mirëkuptim midis palëve, në bazë të kërkesës së një prej palëve në mosmarrëveshje, ERE do ta zgjidhë mosmarrëveshjen dhe do të nxjerrë vendimin e saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Çdo palë në konflikt mund të paraqesë një ankim kundër vendimeve të ERE-s në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga data e publikimit të vendimit në Fletoren Zyrtare.

4. Subjektet e licencuara do të zbatojnë vendimet e ERE-s, deri në një vendim gjykate të formës së prerë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË LICENCË PËR VEPRIMTARINË E OPERIMIT NË HAPËSIRAT E DEPOZITIMIT TË GAZIT NATYROR

Licenca i jepet:

(emri i plotë i të licencuarit)

Seria: _____ Nr. i licencës: _____

Data e hyrjes në fuqi të kësaj shtojce: _____

ANEKS TË DHËNA TEKNIKE

- Vendndodhjen gjeografike të hapësirës së depozitimit nëntokësor _____
- Volumi maksimal i depozitueshëm _____
- Presioni maksimal i rezervuarit nëntokësor _____
- Numri i puseve dhe debitet maksimale të tyre të injektimit dhe të prodhimit _____
- Numrin e njërive të depozitimit _____
- Llojin e gazit të depozitueshëm _____



VENDIM
Nr. 60, datë 25.2.2021

**MBI MIRATIMIN E STANDARDEVE TË
TRAJTIMIT TË ANKESAVE TË
KLIENTËVE TË ENERGJISË
ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR
NGA TË LICENCUARIT NË
AKTIVITETIN E FURNIZIMIT**

Në mbështetje të neneve 20, germa “ë”; 81, pika 3, germa “ç”; 94, pika 2, germat “b” dhe “e”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 16, pika 16 dhe 20; 17, pika 1, germa “ë”; 96, pika 11; 98, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të neneve 52/2 dhe 56, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar; të nenit 28, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar; të “Rregullores mbi kushtet e përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundor”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 203, datë 18.12.2017, të “Rregullave mbi kushtet e përgjithshme të shërbimit të furnizimit me gaz natyror për klientët fundor”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 161, datë 9.7.2018, të “Kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundor”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 15, datë 10.1.2018, të “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017, si dhe të neneve 15 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 25.2.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 30/4 prot., datë 16.2.2021, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike,

konstatoi se:

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 218, datë 15.12.2020, filloi procedura për miratimin e “Standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit”.

- Me shkresën nr. 1315 prot., datë 30.12.2020, ERE kërkoi nga palët e interesit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Furnizuesi i Shërbimit Universal, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike, Autoriteti i Konkurrencës, Ministria e Mirëqenies Sociale, Ministria për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Avokati i Popullit, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë, Shoqata e Konsumatorit, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë të shprehnin opinionet dhe komentet e tyre mbi draftrregulloren brenda 30 ditëve nga marrja dijeni. Në përfundim të këtij afati, përkatësisht data 30.1.2021, nuk rezultoi të ketë asnjë koment, vërejtje apo sugjerim nga palët e interesit në lidhje me përmbajtjen e draftrregullores. Rregullorja me të cilin Bordi i ERE-s ka filluar procedurën është publikuar në faqen zyrtare të internetit të ERE www.ere.gov.al, në zërin konsultime.

- Së fundmi, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 280 prot., datë 3.2.2021, Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU sh.a.) ka depozituar opinionin e tij mbi draftin e “Standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit”. FSHU sh.a. propozon ndryshime për sa u përket nenit 7, pika 3; nenit 8, pika 3 dhe nenit 9, të draftit të “Standardeve të trajtimit të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit”.

- ERE gjykon të domosdoshme që klienti të marrë dijeni në lidhje me numrin që merr ankesa e tij, në një nga format e njohura të komunikimit, të gjurmueshme dhe të dokumentueshme (*e-mail*, sms, tel). Gjithashtu, FSHU sh.a. në kërkesën e saj për ndryshimet në nenin 7, pika 3, të draftrregullores nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me peshën që zë në ankesa të adresuara nëpërmjet postës shqiptare, krahasuar me ato regjistruar në zyrën e ankesave ndaj klientit apo rrugëve të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Ajo që u konstatua se do të vështirësonte punën e FSHU sh.a. lidhet me parashikimin e vendosur në dispozitën e sipërpërmendur e cila parashikon detyrimin që bashkë me njoftimin e nr. të ankesës FSHU sh.a. të përcjellë, për dijeni të klientit, informacionin në lidhje me veprimin e propozuar për zgjidhjen e



ankesës, ndaj ERE propozon heqjen e këtij parashikimi nga neni 7, pika 3, e draftrregullores.

- Në rezolutën e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në datë 25.6.2020, “Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2019”, përcaktohet se ERE duhet të vijojë punën për monitorimin dhe përditësimin e planit të masave në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit sipas fushës së veprimtarisë së shoqërive të ndara tashmë, si dhe të ndjekë zbatimin me rigorozitet të gjetjeve dhe vërejtjeve të bëra gjatë monitorimit duke u fokusuar në zgjidhjen e ankesave të klientëve me përgjegjësi dhe në kohë sa më të shkurtër. Gjithashtu, t’i kushtojë vëmendje procedurës sesi merr dijeni klienti për trajtimin e ankesës, për të bërë të mundur dokumentimin e informimit të çdo klienti ankues për rezultatin e trajtimit të ankesës nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.), si një aspekt shumë i rëndësishëm i transparencës dhe mbrojtjes së konsumatorit.

- FSHU sh.a. bën me dije se për sa parashikohet në nenin 9: “Vendimi ose çdo veprim i ndërmarrë për zgjidhjen e ankesës, duhet t’i komunikohet ankuesit brenda [5] ditëve punë nga data e marrjes së vendimit”. FSHU sh.a. propozon se ashtu sikurse në këto standarde, por edhe në “Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 15, datë 10.1.2018, janë parashikuar mënyrat nëpërmjet të cilave mund të paraqitet një ankesë nga klienti, të përcaktohen shprehimisht edhe mënyrat alternative të komunikimit të vendimit të marrë për zgjidhjen e ankesës, në varësi të të dhënave të klientit që disponon furnizuesi, si edhe duke pasur si qëllim informimin e ankuesit në mënyrën më të shpejtë dhe të saktë.

- Për sa më sipër, ERE vlerëson të pranohet pjesërisht kërkesa për ndryshimin e nenit 7, pika 3 dhe nenit 8, pika 3, dhe pranimin e plotë të propozimit për shtesa në nenin 9. Përkatesisht ndryshojnë dhe bëhen:

- Neni 7 “Trajtimi i ankesave”, pika 3: “Nëse ankesa është pranuar me postë, brenda 5 ditëve pune pas pranimin të ankesës, i licencuari do të informojë me shkrim, në mënyrë elektronike apo me sms, klientin për kodin e regjistrimit, datën e parashikuar për zgjidhjen e ankesës dhe mënyrën e

komunikimit që do të ndiqet në vazhdimësi me ankuesin.”.

- Neni 8, pika 3, parashikon se: “Pas hetimit i licencuari duhet të informoj ankuesin me shkrim, në mënyrë elektronike apo me sms, për veprimet e ndërmarra për të zgjidhur ankesën dhe për të shmangur problemin.”.

- Neni 9 bëhet: “Komunikimi i vendimit mund të kryhet me çdo lloj forme që dokumenton informimin e ankuesit, pranë çdo përfaqësie të furnizuesit.”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë “Rregulloren mbi standardet e trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit”.

2. Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

STANDARDET E TRAJTIMIT TË ANKESAVE TË KLIENTËVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR NGA TË LICENCUARIT NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT

PJESA E PARË DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Këto standarde kanë për qëllim të sigurojnë një proces të drejtë dhe efektiv të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë, në mënyrë që të përmirësohet cilësia e shërbimit të furnizimit me



energji dhe të rritet besimi dhe kënaqësia e klientëve për këtë shërbim të ofruar nga të licencuarit.

Neni 2 Objekti

Objekti i këtyre standardeve është përcaktimi i kushteve të përgjithshme për trajtimin e ankesave dhe kërkesave të klientëve të energjisë nga të licencuarit për aktivitetin e shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë.

Neni 3 Baza ligjore

Këto standarde hartohen në mbështetje të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar; të vendimit nr. 101, datë 26.8.2008, të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, “Për miratimin e kodit të matjes së energjisë elektrike”; të vendimit nr. 203, datë 18.12.2017, të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë, “Për miratimin e ‘Kushteve të përgjithshme të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët fundor’”; të vendimit nr. 15, datë 10.1.2018, të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë “Mbi miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”; të vendimit nr. 181, datë 10.11.2017, të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë, mbi miratimin e Rregullores “Për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, të ndryshuar.

Neni 4 Përkufizime

Termat e mëposhtëm të përdorur në këto standarde kanë kuptimin e mëposhtëm:

1. “Ligji i energjisë” nënkupton ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

2. “Ankesë e klientit” do të thotë shprehja e pakënaqësisë nëpërmjet postës, *e-mail*, telefonit, apo fizikisht nga ana e klientit në lidhje me një ose disa shërbime të ofruara nga i licencuari, për të cilën kërkohet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë një përgjigje apo një zgjidhje prej të licencuarit.

3. “Kërkesë e klientit” do të thotë kërkimi i një informacioni, këshille, apo veprimi të ndryshëm nga ankesa, e cila bëhet nga ana e një klienti, në lidhje me një ose disa shërbime të ofruara nga i licencuari.

4. Çdo term tjetër i përdorur në këtë rregullore, do të ketë kuptimin e parashikuar në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjin nr. 102/2015, “Për Sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

PJESA E DYTË STANDARDET E TRAJTIMIT TË ANKESAVE

Neni 5 Informimi

1. Furnizuesi duhet të sigurojë në mënyrë lehtësisht të disponueshme për klientët, ankuesit dhe palët e tjera të interesuara, informacionin minimal të nevojshëm për procedurat e trajtimit të ankesave, i cili duhet të pasqyrohet dukshëm në faturën e konsumit të energjisë.

2. Gjithashtu i licencuari duhet t’i ofrojë klientëve publikime të këtij informacioni, në ambientet e shërbimit të klientit të furnizuesit, si dhe në *website*-in zyrtar të furnizuesit.

3. Ky informacion duhet të jetë në një gjuhë të qartë dhe në një format të aksesueshëm për të gjithë. Informacioni duhet të përmbajë minimalisht:

- a) të drejtat e klientëve për të ushtruar ankesë;
- b) afatet e ushtrimit të ankesës;
- c) vendet apo zyrat ku mund të bëhen ankesat;
- d) numrin e telefonit;
- e) mënyra (formati i lejuar) si mund të bëhet ankesa;

f) informacioni që duhet të sigurohet nëpërmjet ankesës (detaje në lidhje me identitetin dhe vendndodhjen e ankuesit, problemi i hasur, data dhe vendi i ndodhjes së problemit, nëse ankuesi kërkon ndonjë zgjidhje, dokumentacioni i



nevojshëm mbështetës, si dhe t'i bëhet e ditur kosto e këtij shërbimi).

Neni 6

Pranimi dhe regjistrimi i ankesave

1. Menjëherë pas pranimi, ankesa duhet të regjistrohet në format elektronik apo të shkruar.
2. Regjistrimi duhet të përfshijë:
 - a) një kod identifikues;
 - b) mënyrën e paraqitjes së ankesës;
 - c) vendndodhjen e objektit të ankesës, si dhe datën e paraqitjes së ankesës;
 - d) identitetin e parashtruesit të ankesës dhe detajet e kontaktit të ankuesit;
 - e) një përmbledhje të ankesës;
 - f) një kategorizim të llojit të klientit apo klientit sipas nivelit të tensionit dhe tarifave;
 - g) llojin e ankesës;
 - h) nëse klienti është ankuar më parë apo jo për të njëjtën ngjarje për të cilën bëhet ankesa dhe nëse po, kodin unik të identifikimit të ankesës së mëhershme.

3. Pranimi dhe trajtimi në afat i ankesave të klientëve, duhet të jetë shërbim i ofruar pa pagesë nga ana e të licencuarit.

Neni 7

Trajtimi i ankesave

1. Pas regjistrimit të ankesës, klientit i bëhet me dije kodi unik i identifikimit me të cilin është regjistruar ankesa.
2. Nëse ankesa është marrë personalisht ose me anë të telefonit, personi përgjegjës, do të regjistrojë në regjistrin e trajtimit të ankesave atë që i është komunikuar klientit, në lidhje me veprimin e propozuar që do të ndërmerret për të zgjidhur ankesën, datën e parashikuar për zgjidhjen e ankesës dhe mënyrën e komunikimit që do të ndiqet në vazhdimësi, siç është rënë dakord me ankuesin.
3. Nëse ankesa është pranuar me postë, brenda 5 (pesë) ditëve punë pas pranimi të ankesës i licencuari do të informojë me shkrim, në mënyrë elektronike apo me sms, klientin për kodin e regjistrimit, datën e parashikuar për zgjidhjen e ankesës dhe mënyrën e komunikimit që do të ndiqet në vazhdimësi me ankuesin.

4. Të gjitha komunikimet ndërmjet të licencuarit dhe ankuesit, lidhur me ankesën, do të regjistrohen duke respektuar kodin unik identifikues.

Neni 8

Zgjidhja e ankesës

1. I licencuari do të bëjë çdo përpjekje për të hetuar dhe verifikuar të gjitha rrethanat dhe të dhënat lidhur me ankesën e regjistruar.
2. I licencuari mund të kërkojë informacion shtesë nga ankuesi, brenda 5 (pesë) ditëve punë pas pranimi të ankesës.
3. Pas hetimit, i licencuari duhet të informojë ankuesin me shkrim, në mënyrë elektronike apo me sms, për veprimet e ndërmarra për të zgjidhur ankesën dhe për të shmangur problemin.
4. Në rastet kur ankesa rezulton e drejtë, veprimet korrigjuese apo kompensimi i klientit bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Afati maksimal i trajtimit dhe zgjidhjes së ankesave është 30 (tridhjetë) ditë pune nga regjistrimi i ankesës.

Neni 9

Komunikimi i vendimit

1. Vendimi ose çdo veprim i ndërmarrë për zgjidhjen e ankesës, duhet t'i komunikohet ankuesit brenda 5 (pesë) ditëve punë nga data e marrjes së vendimit.
2. Komunikimi i vendimit mund të kryhet me çdo lloj forme që dokumenton informimin e ankuesit pranë çdo përfaqësie të furnizuesit.

Neni 10

Ankesa në lidhje me veprimet e një punonjësi

1. Nëse ankesa ka të bëjë me veprimet e një punonjësi të të licencuarit, ankuesi duhet të sigurohet që të dhënat personale të tij do të mbahen konfidenciale, për aq kohë sa të jetë e nevojshme për zgjidhjen e ankesës. Kjo për të shmangur çdo konflikt interesi të mundshëm.
2. I licencuari duhet t'i japi mundësi punonjësit për të shpjeguar rrethanat në të cilat ka ndodhur sjellja e ankuar.
3. Nëse ankesa në lidhje me sjelljen e një punonjësi rezulton e pabazuar dhe nuk kërkon një



masë disiplinore, punonjësit duhet t'i jepen udhëzimet e duhura se si të përmirësojë sjelljen dhe veprimet e tij në lidhje me klientët.

4. Në çdo rast, klientit do t'i bëhet me dije në lidhje për sa është konstatuar, si dhe zgjidhjen që i është dhënë ankesës.

Neni 11

Analiza, vlerësimi dhe monitorimi i procedurave për trajtimin e ankesave

1. I licencuari duhet që çdo tre muaj të analizojë ankesat e pranuar për të identifikuar problematikat e përsëritura, me qëllim eliminimin dhe minimizimin e problemeve të tilla në të ardhmen dhe përmirësimin e shërbimit.

2. I licencuari do bëjë një klasifikim të ankesave sipas aneksit 2, bashkëlidhur këtyre standardeve.

3. I licencuari do të publikojë në faqen e tij zyrtare të internetit, një herë në vit, raport mbi numrin e ankesave të regjistruara, problematikat, masat dhe veprimet e ndërmarra për eliminimin e tyre, si dhe afatet brenda të cilave janë trajtuar apo zgjidhur ankesat.

4. I licencuari duhet të monitorojë performancën e trajtimit të ankesave për të siguruar që ajo i plotëson standardet e përcaktuara në këtë dokument.

5. I licencuari do të testojë periodikisht, çdo 6 muaj, nivelin e kënaqësisë së klientëve përmes procedurës së trajtimit të ankesave, kryerjes së sondazheve të rastësishme të ankuesve dhe anketave *online*.

6. Rezultatet e sondazheve të kryera nga i licencuari do të publikohen në faqen e internetit të licencuarit jo më vonë se fundi i vitit kalendarik.

Neni 12

Paraqitja e ankesës në ERE

1. Çdo klient ka të drejtë të drejtohet për ankesë pranë ERE-s në këto raste:

a) pasi të ketë përfunduar procedurën e trajtimit të ankesave pranë të licencuarit dhe nuk mbetet i kënaqur nga përgjigja e dhënë nga i licencuari;

b) në rast se ankuesi nuk merr një përgjigje nga i licencuari, brenda afatit të parashikuar në nenin 8 të këtyre standardeve.

2. Në çdo rast i licencuari duhet t'i bëjë të ditur ankuesit të drejtën për të ankimuar vendimin e tij në ERE.

3. Nëse klienti zgjedh t'i drejtohet ERE-s për shqyrtimin e ankesës së tij, i licencuari duhet t'i sigurojë parashtruesit të ankesës një kopje të procesverbalit të hartuar për ankesën e tij, si dhe dokumentacionin e nevojshëm për trajtim nga ERE.

4. Rekomandimet e ERE-s, për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave, janë të detyrueshme për të licencuarin.

PJESA E TRETË DISPOZITA TË TJERA

Neni 13

Procedura e brendshme e trajtimit të ankesave

Brenda 45 ditëve nga hyrja në fuqi e këtyre standardeve, i licencuari do të miratojë një procedurë të brendshme për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave, në përputhje me këto standarde.

Neni 14

Publikimi i standardeve

Këto standarde, së bashku me "Procedurën e brendshme të të licencuarit për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të klientëve", publikohet në faqen zyrtare të internetit të të licencuarit dhe në të gjitha zyrat e kujdesit ndaj klientit të të licencuarit dhe mund t'u vihet në dispozicion çdo klienti apo subjekti të interesuar.

Neni 15

Përmirësimi dhe rishikimi i procedurave të brendshme të trajtimit të ankesave

1. I licencuari duhet të rishikojë në mënyrë të vazhdueshme procedurat e brendshme të trajtimit të ankesave, me qëllim që të përmirësojë efektivitetin e procesit të trajtimit të ankesave.

2. I licencuari duhet të ndërmarrë veprimet e duhura për të eliminuar shkaqet e problemeve ekzistuese të cilat kanë ndikuar ose në të ardhmen mund të vazhdojnë të ndikojnë në paraqitjen e ankesave.



Neni 16 Konfidencialiteti

I licencuari është i detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e konfidencialitetit për çdo informacion apo dokument të vënë në dispozicion nga klienti, në lidhje me një ankesë të paraqitur nga ky i fundit.

Neni 17 Raportimi në ERE

1. I licencuari do të paraqesë në ERE çdo tre muaj një raport të detajuar me shkrim, i cili do të përmbledhë:

- a) numrin e ankesave të marra në tremujorin përkatës, të kategorizuara sipas:
 - i. kategorive të klientit;
 - ii. objektit të ankesës (sipas aneksit nr. 2);
 - iii. zonës apo njësisë administrative vendore, në të cilin ka ndodhur ngjarja për të cilën është paraqitur ankesa;
- b) numri i ankesave për secilën kategori që janë zgjidhur në përputhje me pritshmërinë e kërkesave të klientit;
- c) numrin e ankesave për secilën kategori që nuk janë zgjidhur në përputhje me pritshmërinë e klientit;
- d) hapat dhe veprimet që ka ndërmarrë i licencuari për të zgjidhur çdo kategori të problemeve sipas zonave apo njësisë administrative vendore.

2. ERE mund të kërkojë informacion shtesë në lidhje me raportin përmbledhës, nëse e gjykon të nevojshëm.

3. Raportet përmbledhëse tremujore, si dhe çdo informacion shtesë i kërkuar nga ERE, do të publikohen në faqen e internetit të të licencuarit menjëherë pas dorëzimit në ERE.

Neni 18 Hyrja në fuqi

Këto standarde hyjnë në fuqi me miratimin nga Bordi i ERE-s.

Aneksi 1 Elementet kryesore të përgjigjes për trajtimin e ankesës

Elementet kryesore që përmban përgjigja që i licencuari i dërgon klientit, në lidhje me një ankesë/kërkesë, sipas problematikës së trajtuar:

- a) procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës;
- b) veprimet e ndërmarrë;
- c) mënyra e korrigjimit të veprimit;
- d) baza ligjore;
- e) afati për kryerjen e veprimeve korrigjuese;
- f) kompensimet e mundshme;
- g) riparimet e mundshme;
- h) asistencë teknike;
- i) informacion i nevojshëm;
- j) referim për trajtim të problemit;
- k) asistencë tjetër;
- l) kërkesë ndjese;
- m) tregim i ndryshimit të procesit, politikës apo procedurës që ka ndodhur si rrjedhojë e ankesës;
- n) adresimi i të gjitha aspekteve të ankesës.

Aneksi 2 Klasifikimi i ankesave

Kategoria e ankesës	Specifikimet
Lidhja me rrjetin	Tarifa, Vonesa, Pengesë për lidhjen, Tjetër.
Matja	Leximi matësit, Funksioni i matësit, Tjetër.
Cilësia e furnizimit	Cilësia e furnizimit (tensioni), Vazhdimësia e furnizimit, Tjetër,



Praktika të padrejta tregtare	Kontrata dhe shitje, Kushte të padrejta kontraktuale.
Kontrata dhe shitje	Kushte të padrejta kontraktuale, Mungesë informacioni, Konfirmim i urdhrit, E drejta e tërheqjes, Pagesat, Tërheqje nga kontrata, Periudha minimale kontraktuale, Çështje të tjera lidhur me kontrata dhe shitje.
Aktivizimi	Lidhja, Rilidhja pas ndërprerjes.
Ndërprerje si rrjedhojë e mospagesës apo pagesës së vonuar	
Fatura dhe vlerë totale debie	Faturë e gabuar, Faturë e paqartë, Faturë e pajustificuar, Vlerë totale debie, Çështje të tjera.
Çmimet/tarifat	Ndryshim i çmimeve/tarifave, Diskriminim në bazë çmimi, Transparencë e tarifës, Tarifë sociale, Çështje të tjera.
Riparimi	
Ndryshim operatori	Vonesa, Ndryshim i padëshiruar.

VENDIM**Nr. 61, datë 25.2.2021**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË
“RREGULLOREN DHE
METODOLOGJINË PËR LLOGARITJEN
DHE VENDOSJEN E DËMIT
EKONOMIK TË SHKAKTUAR NGA
NDËRHYRJET E PALIGJSHME NË
SISTEMIN E MATJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 77, pika 9, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 15, 19 dhe 26, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 25.2.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 30/6 prot., datë 18.2.2021, të përgatitur nga drejtoritë teknike, mbi fillimin e procedurës për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “Rregulloren dhe

metodologjinë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 232, datë 20.12.2019, ka miratuar “Rregulloren dhe metodologjinë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”.

- Shoqëria Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSSH sh.a.), me shkresën nr. 7997 prot., datë 21.10.2020, ka propozuar disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren dhe metodologjinë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”.

- Shoqëria OSSH sh.a. propozon të përfshihen në nenin 2 të rregullores, “Objekti” edhe rastet si më poshtë vijon:

- ndërhyrje në sistemin e matjes (makineri e hapur) në bokse kolektive;



- përdorues rrjeti me linjë të dytë në bokse kolektive;
- përdorues rrjeti me neuter të këputur në bokse kolektive;
- përdorues rrjeti me faza të shuntuara në bokse kolektive;

- përdorues të lidhur në rrjet pa kontratë.

- Shoqëria OSSH sh.a., propozon ndryshime në nenin 10, të rregullores, si më poshtë:

- Afati i lëshimit të faturës, në kushtet kur OSSH sh.a., punon me sistem faturim me cikël 30-ditor dhe printimi është i tillë, afati lidhur me lëshimin e faturës të jetë brenda 30 ditëve ose ciklit mujor të lexim/faturimit.

- Njoftimi i Furnizuesit të bëhet nga momenti i emetimit të faturës përkatëse, si momenti që zyrtarizon shkëljen.

- Shoqëria OSSH sh.a. duhet të bashkëngjisë edhe draftin e rregullores me formulimet e shtesave të propozuara dhe ndryshimeve përkatëse të neneve të cilat afektohen nga këto shtesa dhe ndryshime, si dhe të paraqesë informacionin shtesë mbi sa propozuar, duke argumentuar sa më qartë nevojën për përfshirjen e këtyre tipologjive të ndërhyrjeve në rregullore, si dhe duke paraqitur llogaritjet e saj mbi kundërvlerën në lekë të dëmit ekonomik, i cili do t'u faturohet përdoruesve të rrjetit për shtesat dhe ndryshimet e propozuara.

- “Rregullorja dhe metodologjia për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 232, datë 20.12.2019, në nenin 13, përcakton se kjo rregullore është objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të ERE-s.

- Ndryshimet e propozuara në nenin 2 të rregullores, nuk argumentohen nga OSSH sh.a. dhe nuk saktësojnë kategoritë e shkaktuesve të dëmit të cilët duhen përfshirë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e një ndryshimi në nenin 10, të “Rregullores dhe metodologjisë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”, për afatet e lëshimit të faturës për Përdoruesin e Rrjetit dhe njoftimin e Furnizuesit.

2. Refuzimin e propozimit për ndryshim të nenit 2, të “Rregullores dhe metodologjisë për llogaritjen dhe vendosjen e dëmit ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike”.

3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 62, datë 25.2.2021

MBI HEQJEN E LICENCËS NR. 53, SERIA NPM08P, DHËNË SHOQËRISË “ALB WIND ENERGY” SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 13, DATË 28.1.2008, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 7, 8 dhe 9, të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.2.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 30/5 prot., datë 17.2.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 249, datë 21.12.2020, vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “ALB Wind Energy” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 13, datë 28.1.2008, i ndryshuar.



2. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “ALB Wind Energy” sh.p.k., nr. 53, seria NPM08P.

- Shoqëria është njoftuar për këtë vendim me shkresën e ERE-s nr. 1327 prot., datë 31.12.2020, nëpërmjet së cilës është informuar se ka 30 ditë kohë për të paraqitur argumentet e saj të mundshme me shkrim, nga marrja e kësaj shkrese.

- Në kuadër të projektit të asistencës që Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, (MIE) ka marrë nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për ndërtimin e parqeve eolike, brenda afatit gjatë të cilit shoqëria kishte të drejtën për t'u përgjigjur me shkrim, është përcjellë në ERE një MEMO mbi statusin ligjor të licencave ekzistuese për prodhimin e energjisë elektrike nga era dhe revokimin e mundshëm të tyre, si dhe një studim mbi zonat potenciale për ndërtimin e këtyre parqeve eolike dhe zonat në të cilat, për shkak të statusit të tyre, nuk mund të ndërtohen parqe të tilla.

- MIE, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 714/1 prot., datë 13.7.2020, ka bërë me dije qëndrimin e saj si vijon: “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) nuk është dakord me shtyrjen e afatit të licencave të lëshuara nga ERE për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese nga energjia elektrike eolike, pasi është në fuqi baza ligjore për të aplikuar për ndërtimin e impianteve eolike sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”. Të njëjtin qëndrim MIE ka mbajtur edhe në takimin e datës 3.2.2021, të zhvilluar mes përfaqësuesve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe ERE-s, duke theksuar se nuk duhet të zgjaten afatet e plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit të këtyre subjekteve, pasi kjo mund të binte në kundërshtim me strategjinë e MIE-s për zhvillimin e procedurave konkurruese për ndërtimin e këtyre objekteve gjeneruese, të cilat kanë mundësinë e marrjes pjesë në ankandin që do të zhvillohet.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) ka publikuar njoftimin për hapjen e ankandit të kapaciteteve të reja gjeneruese, nëpërmjet linkut [Shprehje Interesi - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë \(infrastruktura.gov.al\)](https://www.infrastruktura.gov.al/shprehje-interesi-ministria-e-infrastrukturës-dhe-energjisë).

- Pas përfundimit të afatit të përcaktuar prej 30 ditësh nga marrja dijeni, shoqëria “ALB Wind Energy” sh.p.k. nuk ka depozituar në ERE as informacion, dhe as dokumentacion dhe nuk ka marrë masa për të shmangur shkakun ligjor që çoi ERE-n në fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 9, germa “c”, të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se:

Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas neneve 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë, për:

c) të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe/ose “d”, të nenit 5, të kësaj rregulloreje, në bazë të propozimit të paraqitur në raport, në përputhje me nenin 8, të kësaj rregulloreje.

- Me heqjen e kësaj licence, shoqëria “ALB Wind Energy” sh.p.k. nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE, licenca bëhet e pavlefshme, ajo nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte licencuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të heqë licencën nr. 53, seria NPM08, dhënë shoqërisë “ALB Wind Energy” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 13, datë 28.1.2008, i ndryshuar.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për këtë vendimmarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



KËRKESË
Nr. 3219, datë 6.4.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësimin, *për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga "Vendosja e servitutit të kalimit"*, pjesë e projektit të Gazsjellësit Trans Adriatic Pipeline (Projekti TAP), në zonat Berat, Skrapar, Fier, Devoll dhe Korçë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Trans Adriatic Pipeline AG Shqipëri.

Me anë të këtij publikimi, *kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim*, për pasuritë e

paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, në zbatim të ligjit të posaçëm nr. 116/2013, datë 15.4.2013, në përputhje me Planin e Rehabilitimit të Jetesës, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1,948,630.36 (një milionë e nëntëqind e dyzetë e tetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë pikë tridhjetë e gjashtë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Etjen Xhafaj

LISTA EMËRORE PARAPRAKE PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, PËR PASURITË E PALUAJTSHME PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA VENDOSJA E SERVITUTIT TË KALIMIT

Nr.	Emri	ZK	Nr. pas.	Lloji i pas.	Sip. m ² e servitut	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera lekë	KOMENTE ASHK
1	YZEDIN QEMAL MYZYRI	1270	34/22	arë	20	414	8,280.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
2	HILMI RAMADAN MYZYRI	1270	15/11	arë	1	414	414.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
3	MYRTO VESEL DANUSHI RRAHIME VESEL DANUSHI YLLI MYRTO DANUSHI KOSTA MYRTO DANUSHI	1270	19/41	arë	1	414	414.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje, kontratë servituti dhe VKM-nr. 6, datë 9.1.2019 për marrje në përdorim të përkohshëm në favor të TAP AG.
4	LAZE ALI DOSTI	1270	19/8	arë	9	414	3,726.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
5	HYSEN SHAHIN DEMIRI	1270	19/45	arë	1	414	414.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
6	JASHAR FASLI DEMIRI	1270	19/20	arë	1	414	414.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
7	MUSTAFA SAKO DOSTI	1270	19/5	arë	1	414	414.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
8	DYLBER BARJAM LUSHKA	1270	19/19	arë	1	414	414.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
9	PERPARIM HYLM RUKU	1678	223/91	arë	1	414	414.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
10	NAZMIJE SAFET TARE	1678	223/25	arë	1	414	414.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
11	ISMAIL REFAT PUPA NAZIFE HYSEM PUPA BURBUQE ISMAIL PUPA	1678	223/108	arë	9	414	3,726.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
12	ERVIS PETRIT RUCI	1678	219/55	arë	1	325	324.50	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
13	PETRIT MALO ÇILI	1678	219/30	arë	1	325	324.50	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
14	FLORJAN AZIZ CURRA	1678	223/39	arë	16	325	5,192.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
15	QAZIM ZETE TORBA	1678	219/2	arë	47	325	15,251.50	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
16	JANI NAUN GOLEMI	2075	544/10	arë	5	414	2,028.64	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
17	JANI NAUN GOLEMI	2075	545/1	arë	19	414	7,866.48	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
18	ISLAM DINE DANUSHI	2075	537/48	arë	1	414	360.19	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.



19	NURIJE MUSTAFA SULOVARI	2349	69/33	ullishte	10	260	2,595.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
20	BESIM MUSTAFA SULOVARI	2349	69/36	ullishte	7	260	1,816.50	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar VKM nr.246 dt 30.03.2016 për marrje në përdorim të perkohshëm dhe servituti kalimi të përhershëm në favor të TAP AG.
21	BESIM MUSTAFA SULOVARI	2349	66/24	arë	1	260	259.50	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
22	MUSTAFA XHELAL TABAKU	2381	955/32	arë	2	260	519.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
23	FLORIKA SIK DHIMITRI + B/PRONESI	2381	962/144	ullishte	8	260	2,076.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
24	NADIR DYLBËR DYRMO	2381	962/58	ullishte	7	260	1,816.50	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
25	NADIR DYLBËR DYRMO	2381	962/60	ullishte	10	260	2,595.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
26	MILTO SULO SOFIA	2381	962/54	ullishte	11	260	2,854.50	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
27	NADIRE SULO DROBONIKU DENIS NISTRET DROBONIKU	2381	962/39	ullishte	2	260	519.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
28	FEIM SELIM HIMI	2570	635/1	arë	26	260	6,747.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
29	YLLI PELIVAN ALIMETAJ	2570	640	arë	9	260	2,335.50	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
30	GRAMOS NEIM MUÇO	2632	36/11	arë	6	260	1,557.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
31	HAXHI SULEJMEN BALLIU	2848	19/3	arë	2	414	828.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
32	KUJTIM GANI ZYLFO	2848	84/44	ullishte	1	260	259.50	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
33	VIKTOR ILJAS ALLKO	2848	21/8	arë	1	414	414.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
34	HAKI BILAL SALIAJ	2848	68/91	ullishte	1	260	259.50	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
35	ALI MEDI DARDHA	2848	66/177	vresht	4	290	1,160.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
36	MURAT DINE HAJDARAJ	2881	473/17	arë	7	414	2,898.00	Konfirmuar nga ASHK-ja.
37	ADRIATIK BARJAM KOTOLLAKU VITORINA FLAMUR KOTOLLAKU DONALD ADRIATIK KOTOLLAKU	2881	523/11	arë	4	414	1,656.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
38	SADIK HAMIT HAJDARI	2881	469/34	arë	1	414	414.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
39	TAFIL FERIT KOTOLLAKU	2881	523/7	arë	2	414	828.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
40	ELIDON SOTIR KERI	3003	73/137	ullishte	6	260	1,473.96	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
41	FERRIK JONUS CJAPI	3003	73/77	ullishte	2	260	519.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
42	KRENAR HEKURAN HATIJA	3173	49/32	arë	32	414	13,111.38	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
43	GAZMEND QAMIL ÇALA	3173	39/6	arë	38	414	15,732.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
44	ILIA JONUS ZHUPA	3173	49/33	arë	31	414	12,796.74	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
45	KRENAR HEKURAN HATIJA	3173	50/15	arë	61	414	25,191.90	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
46	FERDINANT FETAH HATIJA TEFTA BARJAM HATIJA	3173	42/7	arë	90	414	37,260.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
47	ERVEHE ISUF ÇALA	3173	20/11	arë	2	290	611.90	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
48	DONIKA LILI PALLA	3504	105/15	ullishte	1	260	259.50	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
49	VIOLETA LILI PARANGONI	3504	105/16	ullishte	8	260	2,076.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
50	SELVI ZAHO PIRJASI	3619	804	arë	17	414	7,038.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje, kontratë servituti dhe VKM-nr.768 datë 20.12.2017 për marrje në



								përdorim të përkohshëm në favor të TAP AG.
51	BEHAR ABAS PIRJASI	3619	806/1	arë	2	414	828.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje, kontratë servituti dhe VKM-nr. 768, datë 20.12.2017 për marrje në përdorim të përkohshëm në favor të TAP AG.
52	BEDRI FEJZI KORA	3676	375/28	arë	4	260	1,038.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
53	FATOS IDRIS CALA	3676	343/139	vresht	7	260	1,816.50	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
54	GRETA ENGJELL KAJANA	8505	488/10	ullishte	183	211	38,613.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
55	RESMIJE JAKUP BAJRAKTARI	8504	168/2	arë	1	414	414.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
56	LAVDIJE VEIZ HELMI	8504	168/22	arë	1	414	414.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
57	FERDINAND BESIM BAJRAKTARI	8504	168/3	arë	8	260	2,076.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
58	VALENTINA PASHO KAJO	8504	168/37	arë	4	260	1,038.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
59	BILBIL BEXHET SINANI	8504	168/38	arë	80	414	33,120.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
60	BARJAM QEMAL SALIANJI	8504	168/5	arë	67	414	27,738.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
61	MUHAMET HASAN AGO ANDUEL MUHAMET AGO EMIRA FILE AGO	8504	235/44	arë	80	260	20,760.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
62	NAKO SHABAN GRABOVARI	8504	172/14	arë	1	325	324.50	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
63	ASQERI MEMET SAMZA	8504	168/7	arë	4	414	1,656.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
64	BEXHET XHELAL DUZHA	3759	737/19	arë	121	414	50,094.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
65	NIAZI SHABAN LLOGAÇE	3808	437/4	arë	1	290	290.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
66	PELLUMB HAJDAR ÇELA	3808	412/8	arë	1	414	414.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
67	RAMADAN PASHO MENO	3808	456/8	arë	4	414	1,486.26	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
68	LEFTER SYBI BELICA	3808	412/66	arë	49	414	20,286.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje në favor të TAP AG.
69	SHKELQIM ALI TOSKA	3808	343/35	arë	1	414	413.62	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
70	MYRTEZAN AVDYLL HOXHA	3808	330/236	pemëtore	46	260	11,937.00	ASHK-ja konfirmon se mbi pasurinë është vendosur sekuestro konservative
71	PERPARIM SHABAN MOLLAJ	3808	412/149	arë	1	414	414.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje, kontratë servituti dhe VKM nr. 6, datë 9.1.2019 për marrje në përdorim të përkohshëm në favor të TAP AG.
72	GEZIM KADRI TOSKA	3808	334/78	arë	29	414	11,994.01	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
73	SPIRO ÇERÇIZ PAPA	3808	334/113	arë	1	414	613.43	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje, kontratë servituti dhe VKM nr. 6, datë 9.1.2019 për marrje në përdorim të përkohshëm në favor të TAP AG.
74	LULJETA AVNI NASUFI	3909	1016/4	pyll	621	-	-	Për tu konfirmuar në ASHK
75	MUHAMET RRAPO ALIZOTI	3909	252	arë	29	112	3,233.50	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
76	SYRJA HATEM ALIZOTI	3909	249	arë	9	112	1,003.50	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje në favor të TAP AG.
77	MUHAMER XHEVIT HOXHA	1059	91/17	arë	1	389	420.12	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
78	ADRIATIK AVNI DERVISHI	1059	91/15	arë	3	389	1,104.76	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
79	URIM ENVER HERI	1059	91/14	arë	5	389	1,863.31	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
80	ADRIATIK AVNI DERVISHI	1059	92/9	arë	2	389	805.23	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
81	URIM ENVER HERI	1059	92/10	arë	3	389	1,307.04	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
82	KOSTA NJAZI NUHA SPIRO NJAZI NUHA	1059	89/4	arë	1	389	373.44	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.



83	MUHAMET SAMI MANÇKA	1059	87/15	arë	1	323	323.00	Konfirmuar nga ASHK-ja.
84	DRITON MUANEFI GJALPI	1059	85/19	arë	5	389	1,773.84	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
85	SPIRO FIDAET TAHIR	1059	4/23	arë	1	389	389.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
86	HYSEN BEXHET DULI	1059	5/34	arë	1	389	389.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
87	ALBERT SELADIN DULI	1059	5/27	arë	1	323	323.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
88	GURAZIJE BARI SPAHO	1059	6/24	arë	2	389	778.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
89	MIRDET HASAN SPAHO	1059	7/15	arë	1	389	389.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
90	SAMI HASAN DIKO	3804	1121/16	arë	1	323	323.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
91	SHIPRESA MEHMET KOBLARA	3804	1119/3	arë	22	323	7,106.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
92	NAZIQE MEHMET AJÇE HAKI KASEM AJÇE ENGJELLUSHE KASEM AGOLLI FEJZI KASEM AJÇE ELMIRA KASEM KAMBO TEFTA KASEM GJAMO	3804	1136/63	arë	1	323	303.46	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
93	MUAMER RAPO PIRINGU	3804	239/39	arë	3	321	891.61	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
94	DRITON DEMIR SALA	3804	239/11	arë	1	323	323.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
95	VERA TASIM SPAHO	3804	239/8	arë	3	323	969.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
96	MUAMER QEMAL UZHURI	3804	242/84	arë	44	323	14,212.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
97	FLORENC HAXHI SHEGA	3804	1135/2	arë	1	323	323.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
98	MYZAFER SERVET ZHAVARA	3804	1124/16	arë	2	323	646.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
99	VANGJEL REFIK KAMBO	1202	1127/3	arë	1	323	232.62	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
100	SHEFKET XHUMA ÇIBUKU	1355	31/13	arë	169	389	65,741.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
101	SPIRO BABI HAXHANI	1355	37/24	arë	3	389	1,167.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje, kontratë servituti në favor të TAP AG dhe VKM 641 në favor të MIE.
102	FERZILET SAFET MYTEBERI AUREL IRIAT MYTEBERI ERINDA IRIAT HOXHA	1355	18/16	arë	1	389	389.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
103	MIMOZA VIKTOR HOXHA BRILENT BRUNJEL HOXHA	1355	36/21	arë	10	389	3,890.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje, kontratë servituti në favor të TAP AG dhe VKM 641; 768 në favor të MIE.
104	YLLSON AMELI MYTEBERI	1355	18/17	arë	1	389	389.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
105	SHEFKET XHUMA ÇIBUKU	1355	54/60	arë	1	389	389.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
106	GEZIM ZYDIMULLA	1355	18/53	arë	1	389	389.00	Konfirmuar nga ASHK-ja.
107	SUIT HAKI DERVISHI	1355	6/3	arë	1	389	389.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
108	NEZAQET BARIQ UKA LUMTURIJE BARIQ HODO ALIME BARIQ MULLA DASHMIRE BARIQ MULLA	1355	18/55	arë	6	389	2,334.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
109	HAJRET RAIF MALO	1588	18/1	arë	1	323	406.98	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
110	QAZIM NUREDIN SOXHUKU	1588	18/15	arë	1	323	174.42	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
111	VELEJDIN JASHAR SHAHOLLI	1833	491/7	arë	4	323	1,292.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
112	FIDAI EMIN MUSO	2589	273/91	arë	1	323	323.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.



113	VIKTOR FIDAI FERO	2589	268/2	arë	147	389	57,183.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
114	NEXHDET SEIT SPAHO KATERINA SEIT SPAHO DITURIE SEIT TAHIRAJ FIRDES SEIT MERO RAMIJE SEIT HOXHALLI FITNET SEIT BOGDANI HATIXHE GURTALI SPAHO JORIDA NEXHDET SPAHO ARBEN NEXHDET SPAHO ENDRI NEXHDET SPAHO	2959	333/18	arë	1	389	389.43	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë servituti në favor të TAP AG.
115	MYNEVER ASLLAN XAMA	2959	333/26	arë	1	389	326.77	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
116	JANITAJAR MEDOLLI	3644	1295/1	arë	122	323	39,406.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
117	ALTIN ISLAM BYLYKBASHI	3644	1289/2	arë	1	323	323.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
118	HAXHI ISTREF MEDOLLI	3644	1300/4	arë	3	323	969.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje, kontratë servituti në favor të TAP AG dhe VKM 246 në favor të MIE.
119	DASHAMIR NIJAS REPA	3644	1147/3	vresht	4	203	810.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
120	NIJAS JASHAR REPA	3644	1147/5	vresht	12	203	2,430.00	ASHK-ja konfirmon se është regjistruar kontratë qiraje dhe kontratë servituti në favor të TAP AG.
